

Ana tjetër e medaljes

# KEK-u DHE KOMPLOTI KUNDËR KOSOVËS

**Tregimi për KEK-un është tregimi për një Kosovë të manipuluar në emër të lirisë, të shfrytëzuar në emër të statusit dhe të poshtëruar në emër të partneritetit. Tregimi për KEK-un nuk ka të bëjë me ekonominë, po ka të bëjë me politikën dhe me moralin, përkatësisht me kolonializmin dhe degjenerimin, që kanë plandosur për tokë këtë vend.**



**Milazim KRASNIQI**

**K**ollapsi energjetik i Kosovës është bërë, si përnanga tejzgjatja si përnanga egërsia, i pakonkurrencë edhe për të zënë kryet e vendit në Librin e Ginisit. Tetë vjet pas çlirimit të vendit, kriza energjetike ka mbetur akute si në ditët e para të çlirimit, kur po niste rindërtimi i jetës sociale dhe ekonomike, pas përfundimit të UNMIK-ut dhe levat e tij, instaluan burimet e energjisë për vete, ndërsa KEK-un e lanë anash si të ishte një plaçkë lufte, që mund të ndahej ndërmjet fiseve. Edhe pse administrimi i KEK-ut bie nën autoritetin e Shtyllës së Dytë (që do të thotë të Bashkimit Europian), asgjë europiane nuk u zbatua

për rimëkëmbjen e këtij ish gjigandi energjetik të Kosovës. Përkundrazi, u zbatuan masa të sistemit ushtarak serb kundër Kosovës, i cili resurset energjetike megjithatë nuk i kishte dëmtuar esencialisht. Atëherë, pse ndodhi dhe pse po vazhdon kaq gjatë kjo katandisje?

E para, për shkak se UNMIK-u instaloi një pushtet tipik kolonial mbi Kosovën. Pushteti kolonial është i njohur për të zi për faktin se e rregullon punën si më mirë për vete, ndërsa për banorët e kolonisë nuk i han palla. Me të hyrë në Kosovë, UNMIK-ut për degradimin dhe për shkatërrimin e KEK-ut. Lejimi i mospagësës së energjisë së shpenzuar nga qytetarët dhe ndërmarrjet, ishte dhe mbeti në funksion të blerjes së paqes sociale për rehatinë e UNMIK-ut. Qytetarët që e vjedhin energjinë elektrike dhe ata që nuk i paguajnë faturat e energjisë së shpenzuar, kujtojnë se po u lehtësohet mbijetesa sociale, të cilën UNMIK-u me asgjë nuk ka bërë përpjekje që ta përmirësojë. Fakti që tetë vjet pas çlirimit, Kosova importon 1.3 miliardë euro, ndërsa eksporton vetëm 79 milionë euro, tregon se çfarë politikash ekonomike koloniale janë zbatuar në këtë vend. Fakti që privatizimi ka ulur numrin e të punësuarve, tregon poashtu se për çfarë komploti është fjala. Ndërsa, shumë qytetarë të këtij vendi, fërkojnë duart të gëzuar që shmangin pagesën e energjisë së shpenzuar. Kujtojnë se po ia hedhin UNMIK-ut. Bile, shumë sish kanë mendim të mirë për UNMIK-un dhe për qeverinë. Në të vërtetë, ata janë bërë bashkëpjesëmarrës të shkatërrimit të KEK-ut dhe të degradimit të pa-

surisë më të madhe të vendit të vet, e kjo vetëm sa do ta rritë mjerimin social, edhe të vetë atyre. Por, kur ata ta kuptojnë hilen, UNMIK-u nuk do të jetë këtu, ndërsa Kosova do të kuptojë se i ka humbur tetë vite të mëdha, të cilat nuk mund t'i kompensojë as pavarësia e saj. Kjo paqe e rreme sociale të cilën e ka blerë UNMIK-u, ka rrezik të eksplodojë në Kosovën e pavarur, e të bëhet komplot i ri kundër mbijetesës së saj ekonomike.

E dyta, Qeveria e Kosovës, si zgjatim i pushtetit kolonial të UNMIK-ut, vetëm sa ka shërbyer për të legjitimuar hajninë masive. Duke qenë një qeveri e korruptuar, ajo nuk ka pasur as vullnet e as fuqi që të veprojë për stabilizimin e gjendjes. Minimumi që ka mundur të bëjë Qeveria e Kosovës ka qenë ndihma për mbledhjen e parave për energjinë e shpenzuar. Por, edhe qeveritarëve u ka konvencuar që t'ua japin falas energjinë elektorativ të vet, në këmbim të ruajtjes së votave të tyre. Për të qenë ironia edhe më e madhe, ministri i territ të Kosovës, flet për të ardhmen, për termocentralin Kosova C, në kohën kur Kosova është e zhytur dhe e shkallmuar nga terri. Por, nga përvoja tetëvjeçare e manipulimit, edhe ai ka të drejtë të shpresojë se manipulimi do të vazhdojë edhe më tutje të jep rezultate.

E treta, punonjësit e KEK-ut kanë mbetur të paralizuar në këto tetë vjet. Krahas punës së rëndë më mihje e në termocentrale, ata e kanë mbajtur gojën të mbyllur, pa guxim për të marrë vetë iniciativë. Kanë pranuar pozitën e fajtorit kujdestarë. Kurrkush më shumë se heshtja e tyre nuk ka dëshmuar se ky vend është koloni dhe se qytetarët e këtij vendi nuk e kanë kuptuar se po u vidhet e tashmja e jetës së tyre dhe e ardhmja e fëmijëve të tyre.

Me një fjalë, tregimi për KEK-un është tregimi për një Kosovë të manipuluar në emër të lirisë, të shfrytëzuar në emër të statusit dhe të poshtëruar në emër të partneritetit. Tregimi për KEK-un nuk ka të bëjë me ekonominë, po ka të bëjë me politikën dhe me moralin, përkatësisht me kolonializmin dhe degjenerimin, që kanë plandosur për tokë këtë vend.



Kriza energjetike dhe Kosova

# Planet optimiste për të ardhmen

Gjendja në mihjet e KEK-ut nuk është aq e mirë. Dita ditës rezervat e thëngjillit po pakësohen. Se si do t'ia dalë KEK-u me këtë sistem aq të vjetruar të blloqeve nuk dihet.

Termocentrali i ri "Kosova C", pritet të fillojë punën në vitin 2013, deri atëherë do të ketë reduktime të energjisë elektrike nëse nuk përmirësohet situata e vështirë në blloqet e termocentraleve ekzistuese.

**Lulzim AHMETI**

**E**dhe për kundër investimeve të milionave eurove në KEK nga Qeveria e Kosovës, Banka Botërore, Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER), USAID-i Amerikan dhe donatorë të tjerë, situata energjetike mbetet ende larg përmirësimit. Deri kur kosovarët do ta kenë brengë mungesën e energjisë elektrike, përveç që kjo mungesë po krijon edhe stres tek qytetarët? Ajo i humb buxhetit të Kosovës miliona euro. Edhe sa do të aplikohet plani i famshëm A, B, C i cili nuk aplikohet njësoj në të gjithë Kosovën? Nga reduktimet e energjisë elektrike më keq e pësojnë banorët që

jetojnë nëpër vendet rurale se sa ata në qytete.

Situata e vështirë elektro-energjetike në Kosovë, është një pengesë për zhvillimin e më tej të ekonomik e shoqëror. Kosova me këtë numër popullate ka nevojë për më shumë energji elektrike, se sa prodhohet momentalisht në termocentralet tona. Edhe në rajon vërehet mungesa e energjisë elektrike. Po ashtu edhe kostoja e importit të energjisë po rritet dita ditës sidomos pas hyrjes së Hungarisë dhe Bullgarisë në Bashkimin Evropian, të cilat u detyruan t'i mbyllin reaktorët e energjisë.

Gjendja në mihjet e KEK-ut nuk është aq e mirë. Dita ditës rezervat e thëngjillit po pakësohen. Se si do t'ia dalë KEK-

u me këtë sistem aq të vjetruar të blloqeve nuk dihet.

Termocentrali i ri "Kosova C", pritet të fillojë punën në vitin 2013, deri atëherë do të ketë reduktime të energjisë elektrike nëse nuk përmirësohet situata e vështirë në blloqet e termocentraleve ekzistuese.

Drejtori i departamentit të Energjisë dhe minierave në Ministrinë e Energjisë dhe Minierave Lorik Haxhiu, ka thënë se strategjia e Qeverisë së Kosovës, ka qëllim të sigurojë se procesi i zhvillimit të sektorit të energjisë do të përshpejtohet dhe do të jetë sa më transparent.

Për përmirësimin e situatës energjetike në vend duhet bërë rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese të gjenerimit si dhe



ndërtimi i kapaciteteve të tjera gjeneruese. Buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe Korporata Energjetike e Kosovës nuk kanë kapacitete për të mbështetur kësi lloj projektsh kapitale. Këtu ndihet nevoja për angazhimin e kapitalit privat nga jashtë.

Ministri i Energjisë dhe Minierave, Et'hem Çeku, ka thënë se mungesa e energjisë në Kosovë në planin afat shkurtër dhe afat mesëm mund të tejkalohet vetëm me rehabilitimin e disa njësive të Termocentralit "Kosova A", ose nga importi. "Rritja e çmimit të energjisë në rajon do të thotë se rehabilitimi i blloqeve të TC "Kosova A" është i dobishëm ekonomikisht, ka thënë ministri Çeku. Po ashtu ai ka thënë se që të ketë prodhim të sigurt nga blloqet e "Kosovës B", duhet të ketë mirëmbajtje sipas standardeve më të larta, po ashtu edhe është e nevojshme hapja sa më e shpejtë e minierës së re për furnizim me thëngjill të blloqeve ekzistuese.

### Energjia nga linjiti

Projekti energji nga linjiti mendohet të jetë një projekt serioz i cili do ta shndërron Kosovën nga një vend importues të energjisë në një vend eksportues të energjisë në rajon. Ky projekt ka tri faza të realizimit. Projekti do të përmbajë:

- ndërtimin e termocentralit të ri "Kosova C" me kapacitet të instaluar

deri në 2100 MWh energji elektrike, në të dy fazat dhe kapacitetin e bartjes, b) ndërtimi i një miniere të re të linjtit për furnizimin e njësive ekzistuese gjeneruese (Sibovci jugperëndim), dhe ndërtimi i një miniere të re "Miniera e Sibovcit" për furnizim me thëngjill të termocentralit të ri "Kosova C", c) rehabilitimi i disa blloqeve të TC "Kosova A", për nevojat e furnizimit vendor gjatë periudhës afat mesme.

Faza e parë ka përfunduar gjatë vitit 2006 ku qëllimi ka qenë shprehja e interesit për investime në sektorin energjetik në Kosovë. Nga 10 dhjetë kompani, katër janë zgjedhur nga komisioni vlerësues si kompani për investime në sektorin energjetik kosovar.

Faza e dytë do të përfundojë me zgjedhjen e njërit nga katër ofertuesit kurse faza e tretë, është periudha kur do të nënshkruhen të gjitha kontratat dhe marrëveshjet lidhur me projektin.

### Përfitimet e Kosovës nga projekti

Me realizimin e projekti priten përfitime direkte dhe indirekte, si në nivelin qendror ashtu edhe lokal. Ekonomia e Kosovës do të tërheqë një investim nga jashtë në vlerë prej 3.5 miliard euro.

Ndërtimi i kapaciteteve të reja siguron

furnizim me energji elektrike në Kosovë për periudhën afatgjatë. Kurse meremetimi i disa njësive të TC "Kosova A" siguron furnizim për periudhën afatmesme.

Projekti ndikon direkt në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe në nxitjen e investimeve. Buxheti i Kosovës përfiton të hyra nëpërmjet taksës për shfrytëzimin e linjtit, dhe obligimeve tjera fiskale. Me eksportin e pjesës së mbetur të energjisë do të përmirësohet bilanci tregtar. Eksporti i Kosovës për momentin mbulon vetëm 5 për qind të vlerës së importit. Mjetet e arkëtuara nga biznesi i Termocentralit do të ndihmonin sektorin e Arsimit dhe Shëndetësisë.

Me realizimin e projektit të TC të ri krijohet baza ekonomike për zhvillim ekonomik të Kosovës. Po ashtu me zhvillimin e këtij projekti do të zvogëlohet edhe numri i të papunëve, që në Kosovë është mbi 60 për qind.

Pjesëmarrja e katër kompanive si RWE Power AG nga Gjermania, Konsorciumi CEZ /AES Corporation nga Çekia dhe SHBA-të, Konsorciumi ENEL/ SEN-CAP nga Italia, Greqia dhe SHBA-të dhe Konsorciumi EnBW/ Washington Group Internacional nga Gjermania dhe SHBA-të, me renome botërore në tender dhe realizimi i një projekti të tillë do të jetë sinjal për investime të tjera të mëdha nga jashtë.



Intervistë me rektorin e UP-së prof. Enver Hasanin

# GJENDJA NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS VAZHDON TË MBETET E RËNDË

Gjendja momentale në UP akoma është e rëndë, dhe duhet shumë kohë për ta sanuar. Në rend të parë ajo e mbajtjes me rregull të mësimi. Financat janë një aspekt tjetër, sepse buxheti ynë është i vogël për të përballuar të gjitha nevojat që ka UP. Por, kjo nuk është arsye për t'u zbrapsur nga misioni ynë që e kemi.

**PAQJA:** Sa janë duke u zbatuar reformat në Universitetin e Prishtinës?

**HASANI:** Reformat në UP po zbatohen me vështirësi të mëdha.

**PAQJA:** A mund të na jepni një pasqyrë të gjendjes momentale në Universitet në mënyrën se si ju e shihni atë?

**HASANI:** Gjendja momentale në UP akoma është e rëndë, dhe duhet shumë kohë për ta përmirësuar. Në rend të parë është çështja e mbajtjes me rregull të mësimi. Financat janë një aspekt tjetër, sepse

buxheti ynë është i vogël për të përballuar të gjitha nevojat që ka UP. Por, kjo nuk është arsye për t'u zbrapsur nga misioni që ne kemi.

**PAQJA:** Çfarë mund të na thoni për Universitetin tonë, a mund të na bëni një krahasim të tij me universitetet evropiane dhe më gjerë?

**HASANI:** Jo, për fat të keq. Ne po synojmë që UP-në ta bëjmë një universitet modern, duke ia ndërruar pamjen e jashtme, stafin e tij akademik dhe administrativ, dhe teknikën e punës (siç e dini në përvjetorin e këtij vitit ne kemi lansuar projektin "e-UP 2010", si pilot projekt në

mjekësi dhe teknikë, për të digjitalizuar tërë sistemin tonë të punës).

**PAQJA:** Ka pasur shumë debate rreth asaj që është quajtur reformë universitare. Ka shkaktuar ndonjë efekt kjo reformë, sipas jush apo jo?

**HASANI:** Sigurisht se ka pasur, por edhe dëmet e asaj që është cilësuar si reformë në UP vite më parë kanë qenë të mëdha. Ne po provojmë t'i rregullojmë ato dëme dhe po përpiqemi ta formatizojmë gradualisht UP-në sipas standardeve perëndimore, pra jo vetëm të atyre të Bolonjës. Unë shpesh them se UP ka nevojë për "Bolonjën Plus", që nënkupton rimodelimin e UP-së sipas standardeve të universiteteve perëndimore.

**PAQJA:** A ka literature të mjaftueshme universitare në gjuhën shqipe?

**HASANI:** Jo sa duhet dhe në cilësi të mjaftueshme për të përballuar dijeninë që është përreth nesh. Këto ditë kemi ndarë gjysmë milion EURO për përkthime dhe presim edhe ndihma nga partnerët tanë për të realizuar projektin e përkthimit të teksteve bazë të universiteteve perëndimore.

**PAQJA:** A ka UP-ja kontakte me universitetet botërore?

**HASANI:** Po. Që nga ardhja ime në këtë post, së bashku me kolegët e tjerë, kemi vënë kontakte e marrëveshje me universitetet gjermane, franceze, turke, një në Meksiko, në Belgjikë dhe Holandë, dhe presim edhe me disa universitete në SHBA.

**PAQJA:** Si qëndron puna ndërmjet fakulteteve të UP-së, a kanë ato komunikim mes vete?

**HASANI:** Ne kemi kolegjiun e dekanëve, të cilin e mbajmë dy herë në javë për të koordinuar punët.



Pasi ta bëjmë digitalizimin, punët do të shkojnë më lehtë sepse ky sistem manual i menaxhimit në UP është një pengesë shumë e madhe për punën tonë.

**PAQJA:** Disa nga fakultetet apo departamentet e universitetit ankohen për mungesë kuadrosh mësimdhënëse, të lëndëve dhe profileve të ndryshme. Si do të tejkalohet kjo gjendje dhe çfarë është duke u bërë në këtë drejtim?

**HASANI:** Është e vërtetë kjo që thoni. Ne kemi futur në sistem disa kuadro të rinj. Kryesisht të shkolluar jashtë në lëmit deficitare, dhe së shpejti do të shpallim konkurs masiv për të gjitha drejtimet në UP dhe shpresojmë të thithim terë potencialin e mundshëm të Kosovës.

**PAQJA:** Reformat deri më tani kanë përfshirë dy segmente: reduktimi i lëndëve në disa fakultete dhe zvogëlimi i afateve për provime. A mendoni se këto dy gjëra kanë qenë të tepërta dhe kanë shkaktuar ngarkesë tek studentët, si edhe mundësi të vogla manovrimi?

**HASANI:** Mënyra si janë caktuar lëndët katër vite më herët ka qenë shumë e dëmshme për studentët, sepse ajo i ka stërngarkuar ata dhe ka marrë parasysh vetëm interesin e profesorit e jo të studentit. Përveç kësaj, përllogaritja e kredive është bërë në të shumtën e rasteve me hamendje dhe pa ndonjë cilësi. Këtë do ta përmirësojmë këtë vit dhe në qer-

shor do të kemi një plan të ri të studimeve dhe, për pasojë, edhe një program që është më cilësor dhe sipas standardeve që kërkohen nga ne.

**PAQJA:** Çfarë po bëhet me integrimin e UP-së në sistemin e universiteteve që hyjnë në Kartën e Bolonjës dhe sa afër është UP-ja që t'i plotësojë kriteret e saj?

**HASANI:** Bolonja ka dy anë, atë administrative dhe politike, dhe anën akademike. E para i përket MASHT-it dhe strukturave të qeverisë, kurse e dyta na takon neve. Ne po bëjmë përpjekje maksimale për të kryer pjesën tonë të detyrës.

**PAQJA:** A mendoni se duhet të ketë një bashkëpunim ndërmjet universitetit shtetëror me ato private në Kosovë, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe avancimit të njohurive për studentët?

**HASANI:** Cilësia e universiteteve private në Kosovë nuk mund të jetë model për UP-në, e as si pikë referimi për bashkëpunim të ndërsjellë. Përjashtim nga kjo bën AUK-u, i cili nuk ka kuadrin tonë si mësimdhënës atje. Çfarë logjike ka që të punojmë më universitete private, kur ato në 90% të rasteve kanë kuadrin tonë, që punon atje me honorar dhe jo i rregullt?

**PAQJA:** Kur jeni e m e r u a r

rektor i Universitetit të Prishtinës, keni thënë se do të këtë zero tolerancë ndaj korrupsionit. Sa keni arritur ta realizoni këtë objektiv, si dhe objektivat dhe qëllimet e tjera që i keni vënë vetes?

**HASANI:** Deri më sot nuk është raportuar asnjë rast, sepse në të kundërt do të kishim marrë masat e duhura. Ka pasur vetëm fjalë, jo edhe fakte të prekshme. Unë i inkurajoj të gjithë që të raportojnë rastet e korrupsionit, nëse ka. Dhe bashkërisht të mbrohemi nga dukuritë e tilla.

**PAQJA:** Flitet se në UP disa prej profesorëve ua kushtëzojnë notat studentëve e në veçanti gjinisë femërore. Çka mund të na thoni lidhur me këtë?

**HASANI:** Ju thash më sipër, po të kem ndonjë fakt për një gjë të tillë, sigurisht se do të marrë masat më të rrepta ndaj kryesve të veprave të tilla të shëmtuara.

**PAQJA:** Dhe për fund, cili është mesazhi juaj?

**HASANI:** Studim dhe mësim konstant për studentët, kurse për profesorët mesazhi im është se disa duhet ta kuptojnë se jetojmë në shekullin 21 dhe se duhet t'i lemë filozofit e vjetruara të punës dhe jetës universitare.

Intervistoi

**Nexhati SPAHIU**



Botohet nga O.J.Q. "Zëri Ynë"

## Redaksia

Drejtor: Muhamed Jusufi - KAJOLLI; Redaktor përgjegjës: Shkelzen NUZA; Redaktor gjuhësor: Mimoza SINANI; Redaktor Teknik/Grafika: Osman D. GASHI; Anëtarët e redaksisë: Arber ZEKA, Ilir DESKU, Nexhati SPAHIU, Mergim LUSHTAKU, Gëzim QERIMI; e-mail: revistapaqja@gmail.com, revistapaqja@hotmail.com, revistapaqja@yahoo.com; Adresa: Xhavit Mitrovica, nr. 14 përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë;

Kontakti: +377 44 418 935, +377 44 637 111, +377 44 633 281

Studentët duan më shumë afate për provimet

# PRILLI – AFATI I FUNDIT PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Rektori Enver Hasani gjatë fushatës së tij për rektor ishte kategorikisht kundër afateve të shumta të provimeve dhe po ashtu kishte premtuar se do ta zbatonte statutin e Universitetit të Prishtinës dhe do t'i reduktonte afatet e provimeve nga pesë në tri afate.

Me kërkesën e Parlamentit të Studentëve, senati i UP-së ka marrë vendim që afati i nëntorit dhe i prillit të jenë afate shtesë edhe për vitin akademik 2006/2007.



**Gëzim QERIMI**

**N**jë ndër problemet më të mëdha që ka pasur e vazhdon të ketë Universiteti i Prishtinës në periudhën e pas luftës është afati i provimeve.

Sipas statutit të UP-së, numri i provimeve për një vit akademik është i kufizuar. Në nenin 124 të statutit të UP-së në paragrafin e dytë thuhet: "Afatet e provimeve përfshijnë afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe i vjeshtës (shatorit). Periudha e saktë për çdo afat është e përcaktuar në kalendarin e përgjithshëm të studimeve, i cili është i pranuar nga senati i UP-së dhe është i hapur për publikun."

Mirëpo edhe pse ky statut është miratuar me 5 Korrik 2004 nga Kuvendi i Kosovës, asnjëherë deri më tani nuk është zbatuar. Pengesë kryesore për zbatimin e këtij neni janë studentët të cilët mendojnë se neni 124 i statutit të UP-së duhet të ndryshohet patjetër edhe pse deri më tani asnjëherë nuk është zbatuar ky nen, për shkak të kërkesave dhe presionit të studentëve mbi strukturat e UP-së. Më të zëshmit që e kundërshtojnë këtë nen janë studentët e fakulteteve: juridik, mjekësi, filozofik, filologjik, edukim etj., fakultete në të cilat studenti ka deri në 14 lëndë mësimore brenda një vit akademik.

Por rektori Hasani, ka qasje krejt tjetër rreth këtij problemi. Ai, edhe gjatë fushatës, por edhe deri vonë pasi është bërë rektor, ka pasur qëndrimin se mjaftojnë 3 afate provimesh për një vit akademik dhe është zotuar se ai do ta realizojë këtë menjëherë pas bërjes së tij rektor. Arsyeya kryesore e tij ka qenë reformimi i UP-së dhe në kuadër të këtij reformimi ai ka futur edhe afatet e provimeve.

Parlamenti i Studentëve, dy herë radhazi, ka arritur ta bindë rektorin që t'i

organizojë afatet e provimeve për muajin nëntor dhe tash për muajin prill. Parlamenti i Studentëve kërkesën e vet e ka arsyetuar me faktin se numri i shumtë i provimeve dhe plan programet mësimore të stërngarkuara janë pengesa kryesore për studentët që të kenë sukses gjatë studimeve. Prandaj, afatet shtesë janë një shans i mirë për studentët që ta zënë kushtin dhe për studentët e zellshëm që t'i përfundojnë provimet e mbetura dhe njëkohësisht të fitojnë bursat universitare.

Duke i marrë të gjitha këto si argumente, Parlamenti i Studentëve i UP-së ka arritur ta bindë rektorin dhe Senatin e UP-së se reformimi së pari duhet të filloj nga vet ata, përkatësisht të fillohet së pari me reformimin e plan programeve mësimore, ku me këtë reformë do të kemi programe mësimore më funksionale, e jo programe mësimore të stërngarkuara me të cilat janë ballafaquar studentët e UP-së.

Në kuadër të kësaj reforme pritet që të ketë edhe reduktim të lëndëve mësimore për një vit akademik në mënyrë drastike. Për shembull, deri më tani për një vit akademik studenti i UP-së ka pasur deri në 14 lëndë, mirëpo me reformimin e plan programeve të reja studenti i Universitetit të Prishtinës mund t'i ketë me së shumti 10 lëndë për një vit akademik. Dhe kjo reformë i mundëson studentit të Juridikut dhe studentëve të tjerë që të diplomojnë me vetëm 30 provime, e jo siç është deri më tani ku

duhen 42 provime për përfundimin e studimeve themelore. Kjo reformë do të ndikonte shumë edhe në funksionimin më të mirë të procesit mësimor në Universitetin e vetëm publik në vend.

Reduktimi i lëndëve mësimore është i domosdoshëm pasi është më se e saktë se disa prej lëndëve mësimore janë zbuluar brenda për brenda një nate dhe janë futur në plan programet mësimore vetëm e vetëm që profesori të ligjërojë sa më shumë lëndë dhe fatkeqësisht edhe më e madhe është se, në shumicën e rasteve, njësitë mësimore apo kapitujt e ndonjë librit janë bërë lëndë mësimore. Dhe sipas gjithë kësaj mund të themi se: nëse rektori dhe staffi i tij arrin që t'i reformojnë plan programet mësimore dhe po ashtu t'i reduktojnë lëndët mësimore, atëherë afati i provimeve në muajin prill do të jetë i fundit për studentët e UP-së.

Por është krejt normale që edhe studentët ta mirëpresin një hap të tillë pasi plan programet e reja mësimore nuk do të jenë të stërngarkuara siç kanë qenë deri më tani.

E gjithë kjo mbetet të shihet gjatë vitit akademik 2007-2008, përkatësisht gjatë muajit tetor të vitit kalendarik 2007 ku do të sqarohen shumë gjëra rreth studimeve me programet e reja mësimore si dhe në agjendën e Rektorit, parashihet edhe fillimi i reformimit të UP-së në të gjitha fushat tjera.



**Studentët dhe Organizimi**

# KUVENDI I PARË ZGJEDHOR, VAZHDIMËSI E ANGAZHIMIT

**Paqja Studentore ka organizuar zgjedhjet studentore në 17 fakultetet e UP-së, ku në të gjitha kuvendet kanë marrë pjesë 817 studentë të cilët kanë pranuar të jenë anëtarë dhe përkrahës aktivë të kësaj organizate. Pas një angazhimi të madh, sot kemi një kuvend të Paqes Studentore si organi më i lartë i kësaj organizate. Ky organizim brenda universitar përfaqësohet në të gjitha fakultetet.**



**Nexhati SPAHIU**

**M**ë 13 Mars në lokalet e Fakultetit Filologjik, u mbajt Kuvendi i Parë Zgjedhor i organizatës studentore “Paqja Studentore” e Universitetit të Prishtinës.

Fjalën hyrëse të këtij kuvendi e mori kryetari i Paqes Studentore, Gëzim Qerimi. Ai në fillim foli për rolin dhe themelimin e kësaj organizate, ku ndër të tjera theksoi se kjo organizatë është themeluar nga dëshira dhe vullneti i një numri të konsiderueshëm studentësh të UP-së. Ai gjithashtu vuri në pah se kjo ishte një nevojë për të gjithë studentët pa dallime racore, etnike, fetare, e çfarëdo qoftë tjetër, duke e konsideruar se të gjithë studentët janë të barabartë.

Në fund të fjalimit të tij theksoi se, kjo organizatë ka organizuar zgjedhjet studentore në 17 fakultetet e UP-së, ku në të gjitha kuvendet kanë marrë pjesë 817 studentë të cilët kanë pranuar të jenë anëtarë dhe përkrahës aktivë të kësaj organizate. Pas një angazhimi të madh, sot kemi një kuvend të Paqes Studentore si organi më i lartë i kësaj organizate, i cili përfaqësohet në të gjitha fakultetet e UP-së theksoi

Gëzim Qerimi. Krejt për fund i falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre.

Pas tij fjalën e rastit e mori rektori i UP-së, Enver Hasani, i cili i falënderoi për ftesën dhe njëkohësisht i uroi për arritjet e kësaj organizate si dhe suksese të mëtejshme. Në fjalimin e tij rektori, Enver Hasani, theksoi se ky është një staf mjaft i singërtë dhe korrekt. Ne si rektorat i UP-së, gjithmonë e kemi përkrahur këtë organizatë dhe do të vazhdojmë që gjithnjë të jemi korrekt ndaj studentëve. Paqja Studentore dhe Parlamenti i Studentëve, me koloritin e tyre që iu kanë ofruar studentëve kanë luajtur dhe do të luajnë rol pozitiv. Në veçanti kur është fjala e interesit për zhvillimin e reformave në UP dhe, unë, iu jam mirënjohës edhe pa marrë parasysh se kush do të zgjidhet në kryesinë e re. Ne jemi maksimalisht në shërbim të studentëve aq sa na lejojnë mundësit tona për realizimin e kërkesave dhe dëshirave të studentëve, por ne shumë herë kemi qenë në dispozicion të studentëve dhe do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin e tyre, theksoi rektori i UP-së, Enver Hasani. Ne i kemi inkurajuar të gjitha organizatat edhe organizatën “Paqja Studentore” me një program më të gjërë që të hapen ndaj botës dhe ndaj organizatave tjera si në regjion por edhe më gjerë.

Në fund i falënderoi për organizimin e këtij kuvendi dhe iu uroi suksese të mëtejshme.

Më pas foli edhe kryetari i Parlamentit Studentor, Sejdi Hoxha, ku në fillim të

bisedës së tij ai i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe e lavdëroi Paqen Studentore për punën e bërë dhe mbajtjen e këtij kuvendi zgjedhor të suksesshëm.

I fundit që u paraqit në foltore nga mysafirët ishte Armend Rugova, në emër të Unionit të Pavarur të Studentëve të UP-së dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe njëkohësisht iu uroj suksese të mëtejshme, dhe ndër tjera theksoi se sot Paqja Studentore argumenton emrin e saj që mban me punët e saj të deritanishme.

**Pas votimeve demokratike dhe transparente nga delegatet e kuvendit, dolën këto struktura drejtuese:**

- Gëzim Qerimi –Kryetar i Paqes Studentore
- Mergim Lushtaku –Kryetar i Kuvendit
- Shkelzen Nuza -Nënkryetar organizativ
- Bujar Sejdiu – Nënkryetar për marrëdhënie me jashtë
- Ajshe Kastrati – Nënkryetare e përgjithshëm
- Ernest Kërçeli-Nënkryetar për çështje të brendshme
- Arber Zeka – Nënkryetar për koordinimin e degëve
- Sead Ujkani –Sekretar Organizativ
- Ajete Pllana –Zëdhënëse
- Osman Gashi-Anëtar
- Shkelzen Osmani-Anëtar
- Iliriana Alloqi-Anëtare
- Bernard Tahirbegolli-Anëtar
- Vehbi Berisha –Anëtar dhe
- Artan Spahiu –Anëtar



## Gazetaria Huluntuose në Kosovën e pas Luftës

**A ka gazetari huluntuose në Kosovë?**

**Kosova e pas luftës edhe një herë dëshmoi se nuk mund të ketë shoqëri të lirë pa ekzistimin dhe funksionimin e shtypit të lirë. Demokracia e re në Kosovë nuk mund të funksionojë pa lirinë e shtypit, pa pluralizmin medial, dhe përgjithësisht pa gazetarinë përmbajtësore, të mirëfilltë dhe funksionale.**

## Labinot SMAJLAJ

**G**azetaria kosovare është ashtu siç është edhe realiteti politik, ekonomik, arsimor e qeverisës. Shumë flitet e shkruhet për korrupsionin, krimin e organizuar, vjedhjen, prostitucionin, vrasjet e kërcënimeve, ngaqë realitetin tonë e karakterizojnë këto dukuri të shëmtuara. Rezultat i gjithë këtij kaosi është mungesa e gazetarisë huluntuose, dhe nevojës permanente që ka kjo lloj gazetarie për rrjedhat që po kalon Kosova. Shumë flitet se pse, dhe se cilat janë arsyet që nuk kemi gazetari huluntuose. Ndër arsyet që renditen janë: se ajo kushton shtrenjtë, ka rrezik për gazetarin huluntuos, i duhet kushtuar kohë e gjatë dhe shumë arsye të tjera. Gazetaria kosovare sot thuhet se është e pavarur, madje të gjitha mediat e shkruara dhe ato elektronike regjistrohen dhe mbahen për të pavarura. Realiteti është i kundërt, ngaqë secila gazetë merr donacione dhe mbështetet në forma të ndryshme nga ndonjë subjekt politik apo ekonomik. Mbështetja financiare nga institucionet dhe biznesmenë është

bërë mënyra më efektive dhe shumë efektive, për ndërhyrje në politikat redaksionale, dhe e gjithë kjo rezulton në këtë realitet të gazetarisë sonë. Fakt tjetër është niveli i përgatitjes arsimore, i cili në të shumtën e rasteve është shumë i ulët. Zgjedhja e gazetarëve për punë brenda gazetave është bërë mbi kriteret e afërive familjare, politike e klanore. Ky jo profesionalizëm është më i theksuar tek gjinia femërore, pasi kemi shumë gazetare të pa kualifikuara në aspektin profesional, që asnjëherë nuk kanë menduar se një ditë do të bëhen gazetare dhe se do të moderojnë edhe emisione. Të mahnit pamja fizike e tyre nëpër emisione të ndryshme, por ajo çka shihet dhe dëgjohet në ato emisione është për të të ardhur keq. Kjo rezulton me rënien e interesimit të auditorit për median e shkruar dhe elektronike këtu në Kosovë.

Ndërtimi i sistemit informues-komunikues në Kosovë mbas vitit 1999, megjithatë veçohet me disa specifika krahasuar me proceset në vendet e tjera të Evropës Juglindore. Problemet themelore qëndrojnë në atë se Kosova ka pak vite që ka dalë nga një konflikt i përmasave që tanimë i kemi të njohura pasi kemi qenë vetë dëshmitarë. Nuk duhet harruar edhe gjysmë shekulli i regjimit komunist, ku nuk ka pasur vend për mjetet e pavarura të informimit. Kosova e pas luftës edhe një herë dëshmoi se nuk mund të ketë shoqëri të lirë pa ekzistimin dhe funksionimin e shtypit të lirë. Demokracia e re në Kosovë është e pa mundur të funksionojë pa lirinë e shtypit, pa pluralizmin medial, dhe përgjithësisht pa gazetarinë përmbajtësore, të mirëfilltë dhe funksionale. Pra, ndikimi politik i mediave në zhvillimet shoqërore në Kosovë është i madh dhe i pa diskutueshëm.

Gazetaria huluntuose në Kosovën e pas luftës, ka kaluar dhe po kalon nëpër një situatë jo të mirë, për shumë arsye. Kompleks faktorësh e pamundësojnë

zhvillimin e kësaj veprimtarie si: “është veprimtari që kushton shumë në aspektin financiar, aspekti i sigurisë, animi politik i mediave që rezulton me ikje nga objektiviteti, nuk ka përkrahje nga stafi udhëheqës i medias, faktori kohë (koha e kufizuar)”, thotë Syzana Bytyqi, gazetare në të përditshmen ‘Koha Ditore’.

“Nuk ka gazetari huluntuose në Kosovë, por ka tendenca nga disa gazeta të cilat jo rrallë po sjellin kokëçarje tek institucionet dhe politikanët”, shton më tej Ernest Luma, sipas të cilit numri i madh i masmediave, edukimi i gjeneratave të reja, janë tregues i mirë për zhvillimin e kësaj gazetarie. Sipas tij, gazetarët janë të pa organizuar, përveç disa shoqatave të cilat funksionin dhe veprimtarinë e tyre deri me tani e kanë ushtruar vetëm në letër.

Sipas profesoreshës Evliana Berani: Janë tri elemente kyçe që e pamundësojnë krijimin dhe zhvillimin e gazetarisë huluntuose: 1. Brishtësia e kornizës institucionale (sidomos ngjarjet e fundit), 2. Mungesa e profesionalizmit dhe sigurisë dhe 3. Mungesa e normës juridike. Në bazë të asaj që u tha më herët shihet se e gjithë kjo është si rezultat i mungesës ligjore, por edhe ato ligje që janë nuk respektohen dhe janë shumë fluide, p.sh.: ligji për qasje në dokumentet zyrtare, edhe pse ekziston një normë e tillë ligjore, ajo është shumë konfuze, ngaqë, nuk klasifikon se cilat dokumente janë konfidenciale, dhe këtu gazetari huluntuos është viktimë e këtij mos kategorizimi dhe gjatë ndonjë huluntimi eventual mund të shkelë në “fushë të minuar” dhe pasojat mund të jenë të pa parashikuara, duke filluar nga gjobitja me mjete financiare, deri tek burgu. Faktor tjetër është edhe mungesa e zëdhënësve nëpër institucione, dhe në rastet kur ata ekzistojnë, ata janë shumë të pa kualifikuar.

Gazetarët janë shtresa intelektuale më e pa mbrojtur në aspektin fizik në Kosovë. Rasti më i hidhur në këtë fushë është ai i gazetares Fatmire Tërdevci, e cila u



plagos kur ajo ishte në muajin e shtatë të shtatzënisë. Kjo gazetare kishte zbuluar kontrabandën me karburante në kufirin Kosovë – Mali i Zi, por zyrtarët përgjegjës u treguan të shurdhër për këtë rast dhe kjo gazetare mori guximin që për herë të dytë të shkojë në vendin e ngjarjes dhe të bëjë fotografi si dëshmi më të fuqishme, ku edhe mori plagë me armë zjarri. Profesoresha Berani thotë se “ajo ka qenë ndër gazetaret më hulumtuese që ka pasur Kosova, dhe se nuk e fajëson Fatmirën pse është tërhequr nga raporti hulumtues, pas asaj që i ka ndodhur, dhe se rasti i saj tash e dy vite mbeti i pa zgjidhur”.

Se pse nuk kemi gazetari hulumtuese në Kosovë është më rëndësi të cekim edhe mendimin e avokatit Naser Gjinovcit, i cili në shkrimin e tij me titull “ Neni 187 & 188 i Kodit Penal, fushë e minuar për gazetarët “, shton “ Neni 187 dhe 188 i Kodit Penal të Kosovës duhet që gjithsesi të zhvendosen nga rrafshi penal në atë civil. Në rastet kur një përshkrim i caktuar i gazetarit kualifikohet si fyerje apo shpifje ndaj një personi të caktuar në rrefimin e tij, shumë lehtë mundet

që ky veprim i kundërligjshëm të përshkruhet si shpifje apo fyerje dhe gazetari mund të dënohet me burgim. Gazetari shumë lehtë mund të akuzohet nga këto dy vepra penale, në shkrimet e tij eventuale, prandaj, gjithsesi duhet të bëhet ky ndërrim ose revidim i këtyre dy neneve në Kodin Penal. Paramendoheni situatën e gazetarëve (të çfarëdo mediami qofshin ), kur ata punojnë çdo herë nën presionin e një kërcënim të tillë. Prandaj, ombrella ligjore për gazetarët është e domosdoshme, jo vetëm që ata të mbrohen personalisht, por, edhe që mediumet të mos torturohen nga autocensura”.

Se pse nuk mbështetet kjo gazetari nga institucionet ka mendime të ndryshme. Shpend Limani gazetar në gazetën ‘Express’, thotë se: “në vendet demokratike media nuk subvencionohet nga shteti (nuk është praktikë), dhe kjo për shumë arsye. Ka përplasje interesi që është kryesorja, nga që nëse një medium merr donacione nga ndonjë politikan (institucion) apo biznesmen mund të rrëshqasë nga objektiviteti”. Ky gazetar shton se gazeta në të cilën ai punon ka tendenca dhe ka bërë hapa në rrugën e gazetarisë

hulumtuese, “edhe pse është gazeta më e re në tregun e ideve, kjo media e shkruar, me stafin e saj më profesionist në vend ka arritur tanimë t’i radhitë sukseset në hulumtimin e dukurive negative në shoqërinë tonë”.

Një gazetari e mirëfilltë hulumtuese rezulton me një opozitë konstruktive në çdo shoqëri demokratike dhe të civilizuar. Tashmë është e zakonshme që shtypi, apo më saktë media të thirrët “pushteti i katërt “. Kjo sigurisht që prish skemën klasike të tre pushteteve të Monteskesjës, sipas së cilës, pushteti legjislativë, ekzekutiv ai gjyqësor janë të ndarë nga njëri tjetri. Mjetet kryesore të kësaj “fuqie “ janë: parimësia, objektiviteti dhe drejtësia në pasqyrimin e realitetit historik e shoqëror, besnikëria ndaj popullit dhe interesave të tij.

Po të marrim parasysh ato që u tha më lart mund të vijmë në përfundim se gazetaria hulumtuese në Kosovë është në fazën embrionale të saj. Këtë fazë e kushtëzojnë dy faktorë të rëndësishëm. Po fillojmë më të parin, i cili na bën optimist në zhvillimin e kësaj lëmie, ky është faktori arsimim apo shkollim i gjeneratave të reja. Profesionalizimi i gazetarëve nëpër institucione që tashmë për fat të mirë ekzistojnë, pajisja e tyre me njohuri të kësaj lëmie me norma morale dhe etike, nuk do mend se është për t’u mbështetur, ngaqë e tërë kjo mund të rezultojë në të ardhmen më një gazetari profesionale. Gazetari është i vetëdijshëm për misionin e tij të lartë, dhe e di se mban mbi supet e tij përgjegjësi të mëdha politike dhe shoqërore.

Faktori i dytë, ai ekonomik, çdo ditë e më shumë po e kushtëzon rrjedhën e gazetarisë në Kosovë. Blerja e mediave dhe shndërrimi i tyre në altoparlant të subjekteve të caktuara, tani më është bërë veti e dukshme. Në ambientin e ri të tregut, gazetatat çdo herë e më shumë varen nga të hyrat që marrin nga reklamatat. Kërcënim i që të tërhiqen reklamatat nga institucionet për punë dhe tender janë shndërruar në armë në duar të autoriteteve dhe shumë pronarë gazetash dhe mediash në përgjithësi nuk rrezikojnë të konfrontohen. Këto fuqi të fshehta, nuk kanë ikur, por vetëm kanë ndërruar formën. Nuk është më shteti ai që në mënyra primitive terrorizon mediat hulumtuese, por pronarët e bizneseve të mëdha.

Gazetaria hulumtuese, më fjalë të tjera, po “kryen punë “, ajo mund t’i ndërrojë gjërat, ndoshta nuk mund të bëjë mrekulli sensacionale, por ajo është gjithnjë e më tepër në rritje.



Mediat nga politika

# GAZETARIA NË NDJEKJE TË PARASË, PARAJA NË NDJEKJE TË GAZETARISË

Në shoqërinë tonë, të jetosh e pavarur si media, qoftë e shkruar apo elektronike, është e pamundur. Atëherë, vetëm fat për një informim sa më të lehtë, të drejtë dhe të vërtetë!



Berat DAKAJ

**K**osova e pasluftës, ashtu si partitë politike ka lulëzuar bashkë me mediat e shkruara, ato televizive dhe elektronike. Raporti mes mediave dhe politikës, përkatësisht opozitës dhe pozitës, madje edhe shërbimit të qytetarit, së voni ka marrë kahe të keqe. Informohet me pasiguri dhe pasaktësi, mirëpo sa duhet të ketë nevojë për përkrahje një medie që të jetë e sigurt?

Shumë teoricienë të studimeve masive problemin e informimit e lidhin më këtë rast, si të informohet qartë, shkurt dhe thjesht, dhe më këtë kod gazetaresk si të bëhet një gazetar i domosdoshme e siguruar për mbrojtje nga të këqijat përreth saj.

Faktori popull e merr informacionin ashtu siç i shërbehet nga gazetari, i qartë ose jo, i saktë ose jo, dhe të dytët bëhen viktimë nga të parët, kurse këta shërbyes energjikë dhe të thyeshëm, shpeshherë bëhen vegël dirigjuese e një klase më të lartë të sjelljeve, pikërisht me qëndrimet e ndryshme redaksionale. Këtu, në këtë pikë kufitare mediale mund të vëresh dy figura përfaqësuese: një, që mund të quhej gazetaria në ndjekje të parasë; dhe tjetra që është edhe më fytyrë-egër se e para – paraja në ndjekje të gazetarisë – pushtimit medial.

Një parapolitikë e tillë është gjithnjë relative dhe e dëmshme. Kjo kërkim-ndjekje huazon mjete nga teoria e varësisë, nga “dependenztheoria” dhe më pas e bën lajmin shumë luftarak sa që është vështirë të mbajë frymë në vete, në kuptimin e vërtetësisë.

Publiku, Qeveria me organet institucionale të saj i përcaktojnë temat e përditshme të mediave, madje edhe një person i vetëm bëhet shpesh qendër teme

e gazetës, atëherë kur i ndodh e pazakonsshmja.

Një fuqi bashkimi, media-opinion, mund ta vërejmë në retrospektivë, aty duhet kërkuar vazhdimisht ajo. Në Kosovë kemi shembuj të veçantë lëkundjesh kryeministore. Ndërsa, edhe vendet e tjera ku pushteti i katërt është një armë luftarake më e madhe se edhe fuqia e shtetit, e kanë mundur të keqen.

Në tetorin e 2006-s, opinioni publik suedez i pezmatuar nga imazhet dhe ndërhyrjet e shumta në goditje të veseve të këqija: korrupsionit, mitos etj., arritën që me grushtmedian ta shkarkojnë ministren e Tregtisë së Suedisë, Maria Boreliun, pas së cilës u radhit edhe ministrja e Kulturës, Sesilia Stego Çilo, e cila nga “sulmet” që mori nga populli, qe e detyruar të japë dorëheqje.

Një teori të tillë ndërhyrje nëpër labirintet e mediave në Kosovë nuk kemi pasur rastin ta shohim aq konfliktuoz, ngase parimi i “teorisë së varësisë – dependenztheoria, u mundësonte mediave kalime të lehta përmes flijesh parash, e jo fije arianash.

Megjithëqë politika redaktuese e mediave ë disa nga mediat tona ka bërë kategoritë e saj, që funksionojnë në të keq të popullit, mundësia për shkatërrim të një medie të tillë, është e pamundur.


Blloqet anësore, me të cilat nënkup-

tohet shoqëria e medias me median, e udhëheqësit me udhëheqësin, që përcaktojnë edhe fatin e njëra-tjetrës, i shtrembërojnë edhe shkrimet e lajmit. Lajmi tradhtohet nga pabesnikët e vet dhe më pas tradhton masën.

Publiciteti, marketingu, afishet e ndryshme të cilat paguhen vazhdimisht e që i japin jetëgjatësi gazetës, revistës, e shkatërrojnë në një mënyrë gazetën, ngase shumë gjera të vërteta rreth tyre (atyre që reklamojnë) nuk bëhen publike.

Gazetat në Kosovë sot ekzistojnë nga një forcë “e majtë” dhe “e djathtë” njerëzore, e cila sa është, po aq mund edhe të mos jetë. Një e çelur acari mund të nxisë edhe acarime që më pas si një zë acareje do të merret objekt lajmesh nga gazetata e gjalla. Këto paradokse, në një mënyrë edhe i bëjnë të flasin të tërë përfaqësuesit e gazetës në dobi të tyre. Mundësia e kalimit në prag të të vërtetave përmes gjuhës së komunikimit masiv shpeshherë është e shtrembëruar. Një mito-gjuhësi multimediale brenda në Kosovë është në krizë.

Mirëpo, përfundimisht në shoqërinë tonë, të jetosh e pavarur si media, qoftë e shkruar apo e elektronike, është e pamundur. Atëherë, vetëm fat për një informim sa më të lehtë, të drejtë dhe të vërtetë!



## Postmodernia te shqiptarët

# NDRYSHIMET SHOQËRORE POSTMODERNE

**Demokracia për shqiptarët i hapi portat dhe dritaret e mëdha. Tranzicioni u përshkua me një oreks dhe dëshirë të pakufishme për të pasur. Nga hipersocialja u kalua në hipermaterialen. Realiteti u stërmbush me materialitet, bile edhe mendimi paraqiste një nga format e lëvizjes së materiales. Si hiperdukuri materialiteti pushtoi tërë qenien njerëzore në përgjithësi.**

### Avni AVDIU

**E**shtë mjaft zor të flitet për postmodernen në shoqërinë shqiptare, pikërisht për faktin se asaj i imponua postmodernja pa e kaluar modernen. Në vallen e shoqërores janë futur tradicionallja, modernia dhe postmodernia. Krahe për krahe rrugëve mund të takosh nënë e bijë; e para plakë e rrudhur dhe gati e kërrusur që është e mbështjellë dhe me mbulesë dhe e dyta vajza e saj e re, gjysmëzhveshur ose e veshur me rrobe të tejdukshme. Po ashtu mund të takosh edhe babë e bir, ku plaku me plis në kokë dhe veshje zhguni ec me të riun me flokë të rruar, farmerka të grisura qëllimisht, me vath në vesh dhe tatuazh në krah. Ky kontrast paraqet pikërisht siç do të shprehej Leotar 'paradoksin e së ardhmes (post) dhe të shkuarës (modo).

Ndryshimet në shoqërinë shqiptare janë më se evidente, ndonëse ato zhvillohen disi në mënyrë difuze dhe konfuze. Vërehet tendenca për të ecur me kohën (madje kjo është bërë edhe moto e shumë publiciteteve propagandistike), por në shumë raste vërehet se mungon çelësi-kodi për të qenë në trend. Për rrjedhojë shpeshherë mungon edhe komunikimi brenda shqiptar.

Shqiptarët përmes migrimëve janë shpërngulur sa këtej sa andej dhe pothuajse të gjithë janë zhvendosur nga vendbanimet e tyre falë hapësirës së homogjenizuar. Masa amorfe të cilën Bodrijar e quan 'vrime e zezë', 'nën ndikimin e masmediave absorbon gjithë informatat, rekomandimet, komunikimet – respektivisht tërë shoqërinë. Tani në vend të energjisë shoqërore, kemi masën pasive, e cila është në gjendje apatie'.

Sistemi i kaluar socialist na futi në ngrëhinën kolektivistë, mu ashtu siç i detyron bariu delet që të mos ndahen nga kopeja. Për ta arritur qëllimin ai bërtet, godet me shkop dhe ka në mbështetje edhe qenin besnik. Në mënyrë metaforike të gjitha këto instrumente i pose-

donte edhe regjimi diktatorial. Ndryshon fakti se ai kishte mekanizëm më të sofistikuar për t'ia arritur qëllimit.

Kolektivizmi u shpall si parimi më i lartë moral. Individualizmi gjykohej si mëkati më i madh, mbeturinë e së kaluarës. Ekonomia ndërtohej përmes shoqërizimit të pronës private, e cila duhej të kalonte në duart e leviatanit të quajtur shtet. Shoqërorja vihej mbi individualen dhe në emër të saj, madje në të shumtën e rasteve, duhej sakrifikuar e viktimizuar individualja. Ajo ndërtohej me planifikim, centralizim, me grusht të hekurt...e gjitha dilte nga një mendje e vetme që projektonte arkiteturën hierarkike dhe burokratike të funksionalizimit të pushtetit proletar. Në thelb vetë komunizmi, teoria dhe praktika e tij, mund të vështrohen si dukuri 'hiper'. Hipersocialja e lindi kultin e personalitetit dhe njëkohësisht përjashtoi iluzionin për pavarësi dhe liri personale.

Më pas u bë kalimi frapant nga vizioni tragjik në vizionin katastrofik.

Demokracia për shqiptarët i hapi portat dhe dritaret e mëdha. Tranzicioni u përshkua me një oreks dhe dëshirë të pakufishme për të pasur. Nga hipersocialja u kalua në hipermaterialen. Realiteti u stërmbush me materialitet, bile edhe mendimi paraqiste një nga format e lëvizjes së materiales. Si hiperdukuri materialiteti pushtoi tërë qenien njerëzore në përgjithësi. Tashmë njeriu me profil të ri nuk është ai që ishte. Metamorfoza e tij tani nënkuptonte bredhjen kah e panjohura, drejt X-it, largim nga boshti i qendrës ku ai gravitonte. Qendra humbi, ndërsa realiteti u shpërbë dhe prej tij nuk mbeti gjë tjetër përpos nostalgjisë për të. Realiteti mbeti pas nesh. Qenësimi iu kthye në rivlerësim të vetvetes.

Individualistët e rinj që po dalin gjithnjë e më tepër në shoqëri në kërkim të mundësive të tjera më të mira për veten, shkëputen nga të tjerët për të formuar sensin personal të vetes. Dëshira për ta prekur me çdo kusht luksin, për ta pasur atë dhe për ta zotëruar ka kaluar në mani.

Heqjen dorë nga vlerat tradicionale, si: bujaria, mikpritja, ndihma reciproke, solidariteti, altruizmi, filantropia etj. ata e kuptojnë si mundësi integrimi me botën e qytetëruar, si vlerë dhe kulturë progresiste dhe si mekanizëm për të ndërtuar profilin e ri të personalitetit konform kushteve dhe rrethanave të reja të sapokrijuara. Eurocentrizmi është pikëmbërritje e vetme ku mpleksen ëndrrat, dëshirat dhe planet e gjithsecilit.

Shqiptarët me një shpejtësi të madhe ndërruan edhe mënyrën e pagëzimit të foshnjave. Gjithnjë e më tepër u shfaq tendenca e ikjes nga emrat arab dhe përvetësimi i emrave me domethënie shqipe dhe të huazuar nga yjet perëndimor (të filmave, muzikës, sportit). Disa i ndërruan emrat personal edhe për përfitime materiale (kryesisht në Greqi) për të dëshmuar lojalitetin total ndaj vendit ku punonin, ose edhe për të maskuar identitetin e tyre. Në Kosovë menjëherë pas luftës ishte indikativ pagëzimi i foshnjave me emrat e figurave të politikës botërore që kontribuan në ndërhyrjen e Nato-s. Ish sekretarja amerikane e shtetit Medlin Olbrajt deklaroi në Nju Xhersi më 28 korrik 2006 se: "shumë shqiptarë të Kosovës kanë pagëzuar vajzat e tyre me emrin tim".

Lidhjet fisnore e fqinjësore tashmë janë zbehur ose kanë filluar të shturen. Ftohja midis miqve të dikurshëm, kalon në një mospërfillje totale dhe argumenti është i lehtë për t'u gjetur dhe për t'u arsyetuar gjithçka: kohët janë bërë aq intensive saqë është vështirë edhe të takohesh me të tjerët. Nuk dëgjohen veç se ato biseda që kanë të bëjnë me biznesin, karrierën, famën dhe afirmimin e unit. Thjesht në qarkullim janë vetëm ato fjalë që kanë lidhje me sigurimin e interesit të ngushtë personal. Të tjerat trajtohen si llafë të kota e të bezdisshme, idiotësi ose humbje kohe, pavarësisht se mund të kenë të bëjnë me artin, kulturën dhe me diturinë. Puna nuk është më shenjë identifikuese e suksesit, që siç kuptohej nga etika protestante nënkupton edhe faktin e të

qenët i afërt me Zotin. Zoti më në njëfarë mënyre është abstraktuar.

Në rrethanat e krijuara fitimi synohet me çdo kusht, megjithëse jo përmes punës, por nëpërmjet rrugëve të tjera më të lehta.

Shqetësimi vetëm për të plotësuar nevojat materiale kalon në ankth permanent deri sa më në fund shndërrohet në mani dhe lakmi të pakufishme.

Deleuze është i të njëjtit mendim me postmodernistin japonez Yoshimoto Takai, sipas të cilit konsumi është formë e re e rezistencës. “Doni të harxhojmë, në rregull, ejani të shpenzojmë gjithnjë e më tepër dhe çfarëdo qoftë, pa marrë parasysh synimin e panevojshëm dhe absurd. Kjo është strategjia reale, të cilën ai e quan hiperkonformizëm.

Kjo “etje dhe uri e pashuar dhe e pangopshme” ka dobësuar dukshëm pa-

surinë intelektuale të shoqërisë, duke i zbehur energjitë dhe potencialet e saj. Tashmë edhe mjekët e kanë harruar betimin e Hipokratit. S’ka më etikë mjekësore, s’ka mëshirë, s’ka humanizëm...Kjo më së miri shihet nga rastet e aborteve në klinikat e improvizuara private gjinekologjike. Shumica e klinikave private në Kosovë kryejnë shërbime të abortit edhe të ndaluara me ligj. Nuk ka më mëshirë edhe për rastet kur fryti ka arritur në gjashtë muaj.

Edhe udhëheqësit shpirtërorë, ata që predikojnë fenë, në vend se ta fokusojnë interesimin për përhapjen e bindjeve religjioze dhe përsosjen shpirtërore të popullatës, më tepër interesohen se kush po vdes, ngase marrin para për ceremonitë e varrimit. “Bën si të them


e jo si më sheh”, është sintagma që qarkullon në mesin e predikuesve.

Ndërkaq, autorë të ndryshëm intencë paraprake në shkrimet e tyre ose në krijimtaritë artistike, kanë kalkulimet utilitariste materiale, duke abstraktuar mesazhet e zakonshme etiko-estetike, por edhe edukative.

Ndërkaq për gazetarin e sotëm secili lajm i keq, është lajm i mirë.

Arti nga ana tjetër ka dalë nga kornizat e modernes dhe avangardes. Nuk është më as larpurlartizëm. S’dihet tani se a synon diku, apo është kthyer edhe kundër vetvetes.

Mendësia e re – në krijim e sipër – e shoqërisë është duke u shoqëruar gjithnjë e më tepër me një kompleks të çuditshëm inferioriteti në raport me të tjerët, sa i përket vlerave, traditës dhe kulturës së tyre.



Kosova dhe tranzicioni

# Kapitalizmi global i vë në pikëpyetje të madhe shtet-kombet

Globalizimi që ka pretendimin e promovimit të skajshëm të diferencave sociale, vetëm sa mund të bëhet jo joshës për vendet dhe shtetet të cilat kanë probleme të natyrës sociale. Sot, kjo vlen për shembull sidomos për vendet e tranzicionit, pra për shtetet postkomuniste që janë në kolaps ekonomik, pra janë në një krizë jo vetëm ekonomike, por edhe të identitetit të ri të vlerave morale e politike.

Fadil MALOKU

**F**illimi i viteve tetëdhjetë dhe mbarimi i atyre nëntëdhjetë, në analet shkencore në të gjitha vendet e ish kampit socialist, shënon pa mëdyshje një ndryshim qenësor të zhvillimit të raporteve shoqëroro-politike. Në të vërtetë, rënia e padiskutueshme e standardit jetësor të njerëzve të këtyre vendeve, së bashku me prapambetjen e përgjithshme në sferat e zhvillimit, sidomos tekniko-teknologjik dhe atij ekonomiko-politik të trashëguara nga ish sistemi komunist, bënë që alternativa e socializmit të bankrotojë përpara asaj kapitaliste. Duke parë një ngecje të tillë, vendeve të para iu desh t'i hyjnë procesit të ri të ristrukturimit të gjithmbarshëm politik, ekonomik, kulturor, etj. që në analet shkencore sociologjike shpeshherë identifikohet me konceptin e tranzicionit. Lidhur me këtë koncept, sot në literaturën sociologjike mund të gjejmë interpretime të llojllojshme, sa që është vështirë të bëhet një përkufizim i vlefshëm për këtë fenomen, që aktualisht është duke ndodhur në pothuajse shumicën e vendeve postkomuniste. Dhe jo vetëm në vendet postkomuniste, por edhe në ato që arritën të çlirohen nga zgjedhat e sistemeve totalitare, monarkitë e ndryshme, etj.

**Proces i mundimshëm dhe plot sfida të reja**

Por çfarë kuptojmë në të vërtetë me konceptin tranzicion? Për shumicën e sociologëve të sotëm evrolindorë, interpretimi i Dr. Hafnerit dhe i Kitanovicit, duket shumë i pranueshëm. Ata mes tjerash theksojnë se: me konceptin 'tranzicion' nënkuptojmë proceset që ndodhën në vendet e ish kampit socialist të Evropës, të cilat i kanë parashtruar si qëllim vetvetes kalimin në "ekonominë efikase të tregut dhe në

sistemin demokratik". Varësisht nga specifikat historike, ekonomike dhe shoqërore, dhe varësisht nga situata e brendshme si edhe nga pozita në marrëdhëniet ndërkombëtare të këtyre vendeve, duhet theksuar se ndryshimet në këto vende zhvillohen me intensitet të ndryshëm dhe me koncepte të ndryshme zhvillimore. Mirëpo, meqë qëllimi ynë nuk janë proceset e tranzicionit në vendet e rajonit, por para së gjithash ato në Kosovë, duhet theksuar se ky proces gjithsesi e ka përfshirë edhe atë. Nëse nisemi nga disa para-dispozita sociologjike dhe disa sosh politike, kuptojmë se shoqëria kosovare është futur në rrjedhat e procesit të tranzicionit dhe se shkalla e implikimit të saj në këto rrjedha do të përcaktojë edhe rrjedhat rreth definimit të statusit të saj politik. Themi kështu ngaqë shkalla e implikimit të shoqërisë kosovare në rrjedhat dhe procesin e tranzicionit do ta determinojë padyshim edhe vendin e saj në rajonin e Ballkanit perëndimor. Padyshim që format apo projektet rreth integritetit të mundshëm të shoqërisë kosovare në proceset globale, do të duhej të kishin një strategji të përpunuar mirë nga diskursi shtetëror i Kosovës.

Kjo strategji për mendimin tim do të duhet të përmbajë:

- a) një **dinamikë** të shoqëruar me hulumtime empirike, të cilat në çdo kohë do të japin informacione të duhura lidhur me ecuritë e procesit të tranzicionit në vend, në rajon dhe më gjerë;
- b) një **planifikim** të sofistikuar trefazor (1. afatshkurtër; 2. afatmesëm; dhe 3. afatgjatë) i cili do gjurmonte njëkohësisht shkallën dhe mënyrën e ofertave nga establishmenti politik i vendit; dhe
- c) një **efekt** pozitiv i cili do të mundësonte mobilizimin e qytetarëve në drejtim të animit të diskursit të ri integrues në rajonin e Ballkanit.

Mjerisht, ende nuk është në shesh

ndonjë projekt i tillë i cili do të përcaktonte në mënyrë decizive strategjinë dhe formën më të lehtë të integritetit të Kosovës në një projekt, i cili është duke u punuar aktualisht nga Bashkësia Evropiane. Ai projekt ka të bëjë me vendet e ish-Jugosllavisë – minus Sllovenia plus Shqipëria – dhe është i njohur me emrin Ballkani Perëndimor. Kosova, është futur definitivisht në këtë agjendë të Bashkësisë Evropiane dhe në procesin e globalizimit, që në rajonin tonë (e posaçërisht në vendet e dala nga lufta; Kroacia, Bosnja, Maqedonia dhe Kosova) projektohet dhe keqinterpretohet me sintagma të ndryshme, siç janë ato të tranzicionit, universalizmit, etj.

Pra, nëse bëj ndonjë rekapitullim të interesimit tim lidhur me procesin e futjes së Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë, të cilët rekomandojnë më për së afërmi mënyrat apo format e qasjes në këtë proces shumë delikat edhe për vendet të cilat kanë bërë një traditë të theksuar të ndërtimit të raporteve transitive, mendoj se ky proces, kur shikohet me dioptrinë e analizave shkencore, është i mundimshëm dhe me plot sfida të reja. Por sa është globalizimi në kolizion me procesin e tranzicionit? Në esencë, duhet ritheksuar edhe një herë që globalizimi nuk duhet të identifikohet assesi me universalizmin, që padyshim ka të bëjë me vlerat që e karakterizojnë të gjithë njerëzimin, pa marrë parasysh kohën dhe vendin. Në anën tjetër po ashtu duhet rikujtuar se globalizimi, në kontekst të politikës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare anticipohet gjithnjë e më shumë si një shprehje të cilën e përdorin më së shpeshti shtetet hegjemonike. Qëndrimi që deri diku mendojë se është i arsyeshëm edhe nga aspekti sociologjik, është se trendi i globalizimit sipas të gjitha të dhënave të ekspertëve që merren me dimensionet e ndryshme të këtij procesi i redukton të drejtat e

punëtorëve, dhe me këtë edhe i vënë, të themi kushtimisht, në dilemë hamletiane shtetin social, i cili në kushtet dhe trendet e ashpërsimit të sigurisë sociale është një nevojë elementare e shtresës apo po të përdorim konceptin marksist “e klasës punëtore”.

Këndvështrimi i tillë i globalizimit, për shumicën e sociologëve të sotëm është një princip apo një dioptri e rrallë, apo fare a rrallë, që haset në analizat e gjertanishme, sidomos ato amerikane. Në të vërtetë, globalizimi i tillë që ka pretendimin e promovimit të skajshëm të diferencave sociale, vetëm sa mund të bëhet jo joshës për vendet dhe shtetet të cilat kanë probleme të natyrës sociale. Sot, kjo vlen për shembull sidomos për vendet e tranzicionit, pra për shtetet postkomuniste që janë në kolaps ekonomik, pra janë në një krizë jo vetëm ekonomike, por edhe të identitetit të ri të vlerave morale e politike. Edhe Amerika, që njihet në sytë e opinionit


të gjerë ndërkombëtar si promotore e idesë së madhe mbi globalizimin, dhe që herë-herë identifikohet me “perëndizimin” apo “westernizimin”, edhe sot e kësaj dite nuk ka arritur të krijojë një shtet të fortë social, siç është bie fjala Gjermania.

Shteti amerikan, edhe pse njihet me nofkën e “shpresës dhe tokës së premtuar”, kur janë në pyetje dallimet apo shtresimet e matshme sociale, në të vërtetë, na del si vend apo shtet i cili i përfill shumë pak, apo të mos themi aspak, dallimet sociale. Në anën tjetër, kur është në pyetje kjo dukuri (që aktualisht në Evropë ka filluar të ngrihet në nivelin e një debati të përgjithshëm) kjo temë as që diskutohet si problem që meriton të debatohet në nivele publike. Duhet thënë se kjo mos iniciativë për shoqërinë amerikane nuk mund të shpjegohet si pasojë e ndonjë mosinteresimi apo ndonjë paragjykimi të mundshëm ndaj stratifikimit social, por para së gjithash për shkak

të dallimeve jo edhe aq të konsiderueshme dhe alarmante për diskursin shtetëror amerikan. Amerika, njihet si vend i begatisë dhe i shpresës për shumicën absolute të njerëzve të rruzullit tokësor. Në anën tjetër, qasja e tillë e pretenduar si neo-egalitariste dhe neo-marksiste, që ne e shtruum si problem alternativ më lart, në tokën e Amerikës dhe përgjithësisht në mentalitetin amerikan, nuk ka ndonjë bazë të fortë. Për këtë shkak, shumica e autorëve që merren me problemin e demokracisë liberale e sidomos asaj neo-liberale, konsiderojnë se qasjet e tilla e vënë në dyshim këtë konceptin të perspektivës dhe të prosperitetit për doktrinën e globalizimit.

Tek ne në Kosovë, dhe do të thosha përgjithësisht edhe në mbarë rajonin (meqë konsideroj se nuk ka ndonjë qasje edhe aq të dallueshme për këtë çështje), dhe ndoshta edhe më gjerë, sa i përket diskursit mbi të ardhmen, mbretëron bindja se demokracia liberale është forma më e mirë për ndërtimin e raporteve të ardhshme neo-kapitaliste, përkatësisht globaliste. Arsyet ndoshta mund të qëndrojnë në frustrimin kolektiv që kishin vendet e dala nga diskursi komunist, përkatësisht ai socialist.

Duhet theksuar se kapitalizmi global i vë në pikëpyetje të madhe shtet-kombet, bile edhe ato që e kanë ndërtuar me shekuj identitetin e tyre kombëtar, p.sh., siç është Franca, Gjermania apo Anglia. Globalizimi i aktiviteteve të reja ekonomike, bashkë me krijimin e organizatave të reja mbi-nacionale, bën që identiteti i shtetit si mekanizëm dinamik të zëvendësohet me lehtësi me projektin e sipërpërmendur. Pra, procesi i ri i tipit të demokracisë neo-liberale, padyshim se pretendimin e ka jo vetëm në zëvendësimin e rolit të shtetit si koncept dhe si strategji mobilizuese për masat e gjëra qytetare, por edhe në largimin e tërësishëm të tij nga skena e “transaksioneve historike”, siç kishte ndodhur deri tani. Pra problemi është: si do të jetë e mundur të bëhen këto transaksione pa prezencën e instrumentit të shtetit pasi ai të jetë mënjanuar nga skena e përgjithshme botërore, kur dihet se ai, përveç të tjerave, jep edhe garanci të fuqishme për këto gjëra? Padyshim që kjo është një çështje fundamentale në diskursin e demokracisë liberale dhe të asaj neo-liberale. Përgjigja për këtë projekt-propozim, sipas shumicës së ekspertëve të fushave të ndryshme, ende nuk është në horizont.



Bota dhe Liberalizmi

# Rrënjët e vizionit liberal për botën

Liberalizmi autentik është një impenjim që zë të gjithë jetën, për të cilën sot kemi një nevojë të dëshpëruar. Vetëm nëpërmjet një kuptimi të tillë mund të shmangim fatin e errët të një ere tjetër regjimesh jotolerante dhe kulturash joliberalë.

Armin TIRANA

**P**esë udhëzimet liberale  
Konceptimi origjinal i idesë liberale lindi në botën antike me refleksionin e filozofëve, të cilët vërejtën sesi shoqëria operon brenda një strukture organizimi që i nënshtrohet. Ky konceptim u zhvillua më tej në Mesjetë nga studiues, që kërkuan të individualizojnë tema unifikuese në botën natyrore dhe në atë sociale, në kuadrin e besimit në Zot të nënkuptuar si krijues i çdo rendi. Nëpërmjet punës së tyre shkencore, studiuesit arritën në një kuptim rudimental të shkencave të “reja” si ekonomia dhe sociologjia. “Liberalizmi”, në kuptimin që i atribuojmë sot, ka lindur nga këto zbulime dhe, për pasojë, është rritur deri në një vetëdije të plotë të vetes gjatë Iluminizmit, paralelisht me rritjen e prosperitetit në Europë dhe kur disa sektorë të pasurisë e të sipërmarrjes i tejkaluan aftësitë menaxhuese të shteteve princërore. Në këtë mënyrë studiuesit dhe intelektualët kuptuan se shoqëria dhe strukturat institucionale të saj (familja, ekonomia, institucionet ligjore dhe shoqatat civile) nuk qenë krijuar ose domosdoshmërisht mbështetur nga princër, mbretër

dhe organe të tjera të centralizuar, por, përkundrazi, përmbanin në vetëvete aftësitë për të mbjellë, rritur dhe prosperuar paqen. Konceptimi liberal është i kundërt me vizionin konfliktual të shoqërisë, sipas të cilit në ngjarjet njerëzore progresi lind nga përplasje dhe nga lufta midis individësh të veçantë apo vendesh. Konflikti mund të bazohet mbi idenë e kastës apo mbi afirmimin e fuqisë së vet, duke e dhënë për të sigurtë se zhvillimi sigurohet vetëm me instrumenta pushtimi: se mund të bëhesh i pasur vetëm në kurriz të të varfërve, se të varfërit mund të ngrihen nga gjendja e tyre vetëm, duke shfrytëzuar të varfër të tjerë, se kombet mund të bëhen të fuqishëm vetëm, duke shkatërruar kombe të tjerë ose që religjionet mund të prosperojnë, duke siguruar favorin e të fuqishmëve dhe duke mohuar vlerën e feve të tjera. Ky vizion antiliberal i ka rrënjët e veta në bindjen se organizimi superior i konceptuar nga shkollarët është thjesht një mit naiv. Kurse vizioni liberal e refuzon këtë konceptim konfliktual të shoqërisë dhe thekson se shoqëria njerëzore është në gjendje të prosperojë në paqe pavarësisht të gjitha diferencave të opinionëve. Një shprehje tipike e fjalorit liberal ishte “harmo-

nia e interesave” i të gjithë njerëzve që jetojnë në kushte të lirisë. Liria religjioze kishte një rëndësi themelore në këtë konceptim, sëbashku me shpresën se toleranca religjioze në fund do ta flakte tej prirjen për luftën religjioze. Në kurriz të këtij konceptimi u zhvillua një vizion i impenjimit ekonomik i bazuar mbi beneficet reciproke që derivojnë nga shkëmbimi i vullnetshëm. Ky model përparimi njerëzor i themeluar mbi shkëmbimin u zbatua edhe në marrëdhëniet midis kombeve. Lindi kështu doktrina e tregtisë së lirë, sipas së cilës kombet mund të jetojnë në paqe dhe prosperitet në prirje të një benefici reciprok. Pas apogjeut të liberalizmit në shekujt e tetëmbëdhjetë dhe të nëntëmbëdhjetë, luftërat dhe konfliktet e shekullit të njëzet e kanë shkatërruar konceptimin antik liberal dhe kanë bërë të lindin ideologji të bazuara në bindjen se shoqëria njerëzore është e karakterizuar nga një konflikt implicit që duhet të përballohet dhe jo të shtypet. Nazizmi ka futur papajtueshmërinë e popujve mbi bazën e racës dhe të identitetit kombëtar. Komunizmi ka mbështetur se ekziston një çarje e pashërueshme midis njerëzve bazuar mbi klasën ekonomike. Nacionalizmat e të gjitha llojeve kanë



theksuar se kombet janë nga natura të prirur të impenjohen në luftëra të vazhdueshme. Ideja e planifikimit ekonomik bazohet mbi supozimin se institucione si tregu i çmimeve dhe të drejtat e pronësisë nuk qenë të mjaftueshëm për të koordinuar prodhimin e konsumin dhe se ishte e domosdoshme prania e një komiteti të mençur planifikimi që të përdorte masa shkencore për të drejtuar forcat ekonomike drejt të mirës së përbashkët. Pavarësisht se sot, në fillimet e shekullit të njëzetentjetë, ideologjitë totalitariste nuk gëzojnë më mbështetjen e masave, premisat implicite ideologjike relative ndaj konfliktit njerëzor ekzistojnë në masë të madhe për përcaktimin e axhendës politike. Interesa speciale sforcohen të promovojnë idenë se sekset nuk mund të bashkëpunojnë pa u ndeshur dhe pa një rindërtim kulturor. Nga shumë anë të botës ideja e lirisë religjioze është krejtësisht e panjohur dhe e paimagjineshme. Sa më shumë një shtet impenjohet në projekte administrimi social e kulturor, aq më shumë në mënyrë të shfrenuar grupet e interesit luftojnë për të fituar pushtet politik nëpërmjet legjislacionit apo të një ndërhyrjeje ligjore. Duke e marrë për të mirëqenë se një rilindje e konceptit original liberal është një objektivi i urueshëm, mund të marrim në konsideratë, se cilat virtyte duhet të kultivohen. Duke iu referuar shkrimeve të shkollës së vjetër liberale, mund të propozojmë listën e mëposhtme:

### Tolerancë fetare

Feja prek themelin më të thellë të asaj që jemi dhe të asaj që besojmë lidhur me veten tonë. Për këtë motiv, përfaqëson një aspekt veçanërisht delikat i jetës që i huazohet lehtësisht konfliktit - gjë padyshim ironike, duke parë se pothuajse të gjitha besimet fetare të botës predikojnë virtutin dhe paqen midis njerëzve. Mund të afirmohet e vërteta e një doktrine religjioze dhe në të njëjtën kohë të refuzohet forca për ta imponuar këtë afirmim. Modeli amerikan i lirisë religjioze, megjithëse nuk është i përkryer, përfaqëson një shembull të mirë sesi të gjitha besimet fetare mund të kontribuojnë për beneficin e tyre reciprok.

### Respekt për personin

Refuzimi i skllavërisë dhe i skllavërimit ka qenë një mësim formativ i shkollës së vjetër liberale. Konkretisht, kjo ka nënkuptuar zhvillimin e idesë së pronësisë së vetë personit nënkuptuar si parim parësor i jetës politike. Një person duhet të ketë të drejtën, sapo ka mbushur moshën e rritur, që të marrë vendime të pavarura mbi punën e tij,

stilin e jetës dhe vendin e qëndrimit, si refleks i padhunueshmërisë së ndërgjegjes. Në masën e të mundshmes, kjo do të thotë të kapësh idealet e lirisë së emigrimit dhe emigracionit. Gjatë viteve të fundit, ka lindur një vetëdije e re mbi papajtueshmërinë midis masave të caktuara ndëshkuese, si dënimi me vdekje, dhe domosdoshmërisë për të respektuar vlerën e jetës dhe dinjitetin e personit njerëzor.

### Respekt për pronësinë

Ideologjitë totalitariste bazoheshin mbi premisa false dhe asnjëra prej tyre nuk ishte në gjendje t'i garantonte çdo individ të drejtën për të jetuar i sigurtë në pronën e tij. Në radhë të parë, prona konsiderohet si diçka që duhet të jetë e monopolizuar për të mirën publike, e nënkuptuar në kuptimin e dhënë nga autoritete largpamës. Ky vizion është i papajtueshëm me lirinë. Liria e ndërgjegjes dhe e besimit fetar kërkojnë siguri në të drejtat e pronësisë në mënyrë që një liri autentike të mund të jetohet brenda realitetit ekzistues social. Aristoteli ka shkruar se e njëjta bujari kërkon ekzistencën e pronës private. Ideja moderne e lirisë ekonomike bazohet thelbësisht mbi të drejtën e kontratës dhe shkëmbim i presupozuar nga pronësia private.

### Mbretëria e ligjit

Ky koncept duhet të dallohet nga ideja e mbretërisë së njerëzve, që është për arbitrarë nga vetë natyra


e saj. Të jetosh sipas ligjesh të zbatueshme universalisht do të thotë që ligjet duhet të jenë të pakta, të thjeshta dhe koherente në mënyrë që të mund të arrihet (ose të paktën të imagjinohet) përpjestueshmëria, drejtësia dhe ndershmëria.

### Virtyte personale

Virtytet e sipërpërkruara janë kryesisht të natyrës institucionale: ideale që duhet të pasqyrohen në tipin e sistemit social dhe politik të adoptuar nga shoqëria. Por po kaq të rëndësishëm, bile dhe akoma më shumë themelore për infrastrukturën kulturore të shoqërisë liberale, janë virtytet individuale të bujarisë, të bamirësisë, të durimit, të ndërmarrjes, të kurajos, të shpresës të dashurisë dhe të fesë, të cilat jo të gjitha mund të përkufizohen siç duhet virtyte klasike, por që jo më pak janë themelore për ekzistencën e një shoqërie të lirë. Për të qenë autentikisht liberale, një shoqëri civile duhet të jetë njëherazi e lirisë dhe virtuoze.

Kjo renditje nuk ka pretendimin minimal që të jetë përmblylëse. Studimi dhe kuptimi i liberalizmit autentik është një impenjim që zë të gjithë jetën, për të cilën sot kemi një nevojë të dëshpëruar. Vetëm nëpërmjet një kuptimi të tillë mund të shmangim fatin e errët të një ere tjetër regjimesh jotolerante dhe kulturash joliberalë.

Robert Sirico është bashkëthemelues dhe President i Acton Institute



**Sfidat e shtetit ligjor**

# Ligjet nuk duhet të jenë larg interesave të qytetarëve

**Krijimi dhe zbatimi i ligjshmërisë do të bënte të mundur që të kemi një qytetar aktiv dhe, si rrjedhojë, ky i fundit aktivitetin e tij të çfarëdollojshëm do ta bazonte në ligje, në besueshmërinë dhe respektin ndaj tyre dhe ndaj institucioneve të tyre dhe, si rrjedhojë, do të kishim një shtet funksional dhe prosperues.**

**Arben Muhameti**

**N**e jemi në prag të krijimit të shtetit, po siç duket nuk jemi në rrugën e mbarë të vendosjes së tij në themele të sigurta. Dhe themel i një shteti është legjislacioni. Deri më tani nuk kemi arritur të krijojmë te qytetari ndjenjën e besimit dhe respektit për ligjin, sepse në fakt as që kemi arritur të krijojmë ligje të mirëfillta.


Pas luftës, deri në vitin 2002, legjislacioni ynë ka qenë kryesisht i përbërë nga rregulloret e lëshuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe nga ligjet e miratuara deri në vitin 1989 që nuk kishin karakter diskriminues. Aktet e lëshuara nga PSSP-ja ishin arbitrare, kundërtëhenëse dhe shkaktonin mjaft telashe. Kishte raste kur një rregullore mohonte tjetrën dhe që të dyja vepronin paralelisht, ishin larg qytetarit dhe realitetit objektiv, thënë shkurt krijonin bazën për një politikë të caktuar që zbatohet dhe do të zbatohet në të ardhmen. Kështu ekzistonte një vakum i theksuar ligjor. Me formimin e institucioni tonë ligjvënës u ngjall shpresa për krijimi e një legjislacioni të mirëfilltë, por në fakt për arsye të ndryshme puna e këtij institucioni ishte e zbehtë, jo produktive dhe larg kërkesave imediate të kohës. U arrit të miratoheshin pak ligje dhe ato që janë miratuar deri më sot kanë zbrazëti të mëdha juridike.

Tani, në këtë periudhë duhet të mendojmë seriozisht për ligjshmërinë, të ndërtojmë vizionin për një shtet të fortë juridik, një shtet që do të garantonte fuqimisht liritë dhe të drejtat e njeriut; të drejtën e pronës, lirinë e lëvizjes, pacenueshmërinë e dinjitetit dhe lirisë së fjalës, etj., me një fjalë të gjitha ato kategori kushtetuese që përbëjnë

bazën e një shteti të mirëfilltë. Këto parime edhe mund të jenë formalisht në letër, por problemi ynë serioz është zbatueshmëria, si do të veprohet, çfarë mekanizmesh duhet të krijojmë për zbatimin e tyre, si të arrihet efikasiteti dhe praktikiteti i dëshiruar, etj. Në radhë të parë duhet të kemi kujdes në hartimin e ligjeve, në shumë raste ato janë fiktive, larg interesave dhe nevojave të qytetarëve dhe natyrisht s'kanë si të jenë të efikase. Nevojiten ligje të tilla ku objekt dhe subjekt i tyre të jetë qytetari, ligje që të jenë në pajtueshmëri me rrethanat ekonomiko-shoqërore, shkallën e zhvillimit ekonomik, traditat, zakonet dhe kushtet e tjera specifike të vendit tonë. Në rast se nuk merren parasysh këto kritere, atëherë s'kemi pse të presim rezultate, sepse ligjet duhet të jenë në radhë të parë të ak-

ceptueshme për popullin e gjerë dhe jo për një kategori të caktuar njerëzish. Në këtë mënyrë mund të sigurojmë një solidaritet dhe mirëkuptim të popullit për krijimin e shtetit ligjor. "Kurdo që shqiptohen fjalët 'ligj' dhe 'liri', qytetarët bëhen solidarë njeri me tjetrin", ka konstatuar Perandori dhe ligjvënësi Napoleon. Ai nder të tjera thekson edhe se: "Sa më tepër ndriçohen popujt, aq më tepër binden për dobinë e ligjeve dhe nevojën për t'i mbrojtur ato".

Vetëm krijimi dhe zbatimi i ligjshmërisë do të bënte të mundur që të kemi një qytetar aktiv dhe, si rrjedhojë, ky i fundit aktivitetin e tij të çfarëdollojshëm do ta bazonte në ligje, në besueshmërinë dhe respektin ndaj tyre dhe ndaj institucioneve të tyre dhe, si rrjedhojë, do të kishim një shtet funksional dhe prosperues.



Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

# Kosova edhe më tej në qendër të vëmendjes

Rusia ende nuk e ka bërë të qartë qëndrimin e saj përfundimtar për statusin e Kosovës, por kam besimin se mendimi i SHBA-së dhe i vendeve perëndimore lidhur me këtë status do të dalë fitues.

Demir RESHITI

**V**azhdimi i negociatave në Vjenë ndërmjet ekipeve negociatore të Prishtinës dhe Beogradit e ka mbajtur edhe më tej Kosovën në krye të vëmendjes ndërkombëtare.

Përfaqësues të shteteve dhe asociacioneve ndërkombëtare si dhe analistë të ndryshëm, kanë vazhduar në forma të ndryshme t'i japin përkrahje dokumentit të Ahtisaarit, i cili pas një turi



negociatash në Vjenë, ka pësuar disa ndryshime dhe plotësime, dhe sipas të gjitha gjasave i tillë do t'i paraqitet Këshillit të Sigurimit të OKB-së, i cili edhe do ta ketë fjalën përfundimtare sa i përket statusit të Kosovës. Takimi i fundit në Vjenë ndërmjet përfaqësuesve më të lartë të institucioneve të Kosovës dhe Serbisë, i njohur si "Takimi i Elefantëve", ndonëse ka përfunduar pa ndonjë rezultat, është përfolur gjithashtu shumë në qarqe ndërkombëtare.

Vëmendja ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe është përqendruar edhe në protestat e organizuara nga Lëvizja "Vetëvendosje".

Në vazhdim po e paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, në periudhën 12 shkurt 2007 – 11 mars 2007.

**(12 shkurt) BE-ja mbështet planin e Ahtisaarit**

**Bruksel** - Shefat e diplomacive të Bashkimit Evropian në Bruksel kanë shprehur mbështetjen e tyre për të dërguarin e posaçëm të OKB-së për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari për zgjidhjen e statusit të Kosovës, si dhe kanë përkrahur mbajtjen e konsultave të Vjenës ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.

**(13 shkurt) Wordsworth: Ka pak hapë-**

**sirë për kompromis**


**Beograd** - Ambasadori britanik në Beograd, Stephen Wordsworth, për të përditshmen beogradase "Blic", ka shprehur mendimin se ka pak hapësirë për kompromis ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve për statusin e Kosovës.

**(14 shkurt) Pelikan: Demonstratat e Prishtinës, nuk duhen nënçmuar**

**Pragë** - Demonstratat e fundit në Prishtinë nuk janë epilog e dramës kosovare por paralojë dhe nuk duhen nënçmuar, ka shkruar në gazetën "Pravo" ballkanologu Jaroslav Jan Pelikan.

**(15 shkurt) Ahtisaari: Ka pak gjasë për kompromis**

**Uashington** - Kryenegociatori për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari, në një intervistë për agjencinë amerikane të lajmeve "Associated Press", ka thënë se janë shumë të vogla gjasat për të arritur një marrëveshje ndërmjet Serbisë dhe shqiptarëve të Kosovës.



**(16 shkurt) Ahtisaari: Nuk do të ketë zvarritje të mëtejshme**

**Bruksel** - I dërguari i posaçëm i OKB-së për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari ka deklaruar të premten në Bruksel se nuk pret shumë nga takimi në Vjenë javën e ardhshme. Ai këto komente i ka bërë pas takimit me ambasadorët e vendeve anëtare të NATO-s.

**(18 shkurt) Ruecker: Rusia nuk do të vendos veto në Këshillin e Sigurimit**

**Katar** - Shefi i UNMIK-ut Joachim Ruecker ka thënë se nuk pret veto nga Rusia në Këshillin e Sigurimit për statusin e Kosovës. Ai në një intervistë për

televizionin "Al Jazeera", ka thënë se zgjidhja nuk do të jetë e imponuar por para saj është e domosdoshme që të arrihet marrëveshje për disa pjesë praktike të pakos.

**(19 shkurt) Steinmeier: Nëse dy palët nuk pajtohen, vendimin e merr KS i OKB-së**

**Berlin** - Këshilli i Sigurimit i OKB-së duhet të sjellë vendimin për Kosovën nëse dy palët nuk merren vesh gjatë bisedimeve për planin që e ka propozuar Martti Ahtisaari. Këtë e ka deklaruar shefi i diplomacisë gjermane, Frank-Walter Steinmeier për gazetën "Handelsblat".

**(20 shkurt) "Reuters": Rusia e gatshme të bëjë kompromis për Kosovën**

**Vjenë** - Ahtisaari ka kërkuar nga OSBE-ja që të "ta mbajë praninë e saj gjithëpërfshirëse në Kosovë me një mision të fortë për ta mbështetur punën e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar dhe Misionit Evropian të Sigurisë dhe të Politikës mbrojtëse". Këtë kërkesë Ahtisaari e ka bërë në Vjenë gjatë një takimi me Këshillin e Përhershëm të OSBE-së.

**(21 shkurt) Steinmeier: Nuk do të ketë ndarje të Kosovës**

**Beograd** - Nuk do të ketë ndarje të Kosovës dhe për këtë çështje është i qartë qëndrimi i Grupit të Kontaktit - ka deklaruar shefi i diplomacisë gjermane Frank-Walter Steinmeier, në një intervistë për të përditshmen beogradase "Blic".



**(22 shkurt) Ban Ki- Moon bën thirrje për mbështetje të Ahtisaarit**

**Vjenë** - Sekretari i përgjithshëm i OKB-

së Ban Ki-Moon ka bërë thirrje për të mbështetur të dërguarin e tij Martti Ahtisaari në negociatat për statusin e Kosovës.

**Uashington** - Rusia ende nuk e ka bërë të qartë qëndrimin e saj përfundimtar për statusin e Kosovës, por kam besimin se mendimi i SHBA-së dhe i vendeve perëndimore lidhur me këtë status do të dalë fitues - ka deklaruar për "Zërin e Amerikës", nënsekretari amerikan i Shtetit për çështjet politike, Nicholas Burns.

**(23 shkurt) Plassnik: KS-ja do të pajtohet me zgjidhjen për Kosovën**

**Vjenë** - Ministria austriake e punëve të jashtme, Ursula Plassnik ka deklaruar për të përditshmen austriake "Kourier", se Këshilli i Sigurimit i OKB-së do të pajtohet lidhur me zgjidhjen e statusit të Kosovës.

**(26 shkurt) Solana: Zgjidhja për Kosovën, sfidë kyçe në rajon**

**Bruksel** - Zgjidhja për statusin e Kosovës është sfidë kyçe në procesin e konsolidimit të stabilitetit dhe përparimit të Ballkanit Perëndimor në integrimet evropiane, ka thënë shefi i diplomacisë së BE-së, Javier Solana, gjatë një interviste për të përditshmen sarajevase "Dnevni avaz".

**(27 shkurt) Rehn: Vetoja ruse për Kosovën do ta destabilizojë Ballkanin**

**Berlin** - Vetoja eventuale ruse në Këshillin e Sigurimit të OKB-së ndaj planit të Martti Ahtisaarit për Kosovën, mund të shkaktojë kaos dhe destabilitet në Ballkan - ka deklaruar në Berlin, Komisionari i BE-së për Zgjerimin, Olli Rehn.

**Nju Jork** - Plani i Ahtisaarit përbën shansin më të mirë për Kosovën të ecë përpara dhe praktikisht i jep Kosovës pavarësinë, por me disa kufizime - ka konstatuar e përditshmja amerikane "The New York Times".

**Berlin** - Shefi i diplomacisë evropiane, Javier Solana, ka thënë në Berlin se



çështja e statusit të Kosovës do të zgjidhet para verës.

**(28 shkurt)**

**Uashington** - "Është e qartë se 95 për qind e popullatës së Kosovës dëshiron pavarësi dhe mendoj se kjo është zgjidhja e vetme e qëndrueshme", ka deklaruar ish i dërguari i Presidentit amerikan për Ballkan, James O'Brian.

**(1 mars) Waters: Plani i Ahtisaarit nuk i jep Kosovës pavarësi të vërtetë**

**Uashington** - Plani i Ahtisaarit nuk i jep Kosovës pavarësi të vërtetë, të cilën qytetarët e saj e meritojnë..., ka deklaruar në një intervistë për radion "Evropa e Lirë", eksperti amerikan Timothy Waters.

**(2 mars) Shefat e diplomacive të EJL-së kërkojnë kompromis për Kosovën**

**Uashington** - SHBA-ja mbështet planin e Ahtisaarit për zgjidhjen e statusit final të Kosovës - ka deklaruar nënsekretari amerikan i Shtetit, Nicholas Burns në një fjalim para Këshillit Atlantik të SHBA-së.

**(4 mars) Tadiq: Nuk mund të bëjmë asgjë për ta penguar pavarësinë e Kosovës**

**Beograd** - "Neve nuk na pëlqen pavarësia e Kosovës, por nuk mund të bëjmë asgjë për ta penguar atë", ka thënë presidenti serb, Boris Tadiq.

**(7 mars) Abramowitz: Plani i Ahtisaarit hap drejt shtetësisë**

**Pragë** - Propozimi i Ahtisaarit është një



hap i rëndësishëm përpara drejt krijimit të shtetit, ka deklaruar në një intervistë për radion "Evropa e Lirë", ish diplomati amerikan Morton Abramowitz.

**Pragë** - Zvarritja e zgjidhjes së statusit të Kosovës mund të çojë në ngritjen e tensioneve, ka vlerësuar analisti britanik Tim Judah, për radion "Evropa e lirë".

**(8 mars) Stafford: Forcat amerikane do të mbesin në Kosovë**

**Uashington** - Forcat amerikane do të mbesin në kuadër të KFOR-it, në pajtim me zgjidhjen e statusit të ardhshëm të Kosovës, ka deklaruar profesori i poli-

tikës së sigurisë në Kolegjin Kombëtar Usharak në Uashington, Roy Stafford.

**(9 mars) BE-ja nuk merr përsipër misionin pa një rezolutë të re të KS**

**Bruksel** - Zyrtarët e BE-së kanë deklaruar se BE-ja nuk mund të marrë përsipër misionin e ardhshëm në Kosovë pa një rezolutë të re të Këshillit të Sigurimit të OKB-së me të cilën do të zëvendësohej Rezoluta 1244.

**(10 mars) Takimi i "elefantëve" përfundon pa marrëveshje**

**Vjenë** - Ka dështuar takimi i fundit ndërmjet përfaqësuesve më të lartë të Prishtinës dhe Beogradit, i njohur si takimi i "elefantëve" lidhur me statusin e Kosovës, që është në Vjenë. Sipas ndërmjetësuesit Martti Ahtisaari, "elefantët" e Kosovës dhe të Serbisë nuk arritën të gjejnë një bazë të përbashkët



për diskutime. "Asnjëra palë nuk ishte e gatshme të hiqte dorë nga qëndrimi i saj", ka thënë Ahtisaari, duke njoftuar se do t'ia paraqesë planin e tij për Kosovën Këshillit të Sigurimit të OKB-së deri në fund të marsit. Pas një vit e gjysmë negociatash të ndërmjetësuar nga ish-kryetari i Finlandës, Martti Ahtisaari, Kosova dhe Serbia në asnjë pikë të diskutimeve nuk kanë mundur të pajtohen në mes vete. Ashtu siç është pritur, takimi i 'Elefantëve' nuk ka sj asgjë të re.

**(11 mars) Rehn: Propozimi i Ahtisaarit është kompromis realist**

**Bruksel** - Komisionari për zgjerim i BE-së, Olli Rehn, ka deklaruar se propozimi i kryenegociatorit Martti Ahtisaari për statusin e Kosovës është "kompromis realist".

**Pragë** - Parashikoj që në një periudhë të ardhshme të kemi shtetin e pavarur të Kosovës, por duket se pa pjesën veriore, ka deklaruar në një intervistë për radion "Evropa e Lirë", analisti i njohur Patrick Moore.

# LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT, MESAZH PËR TË HYRË NË FAMILJEN E MADHE EVROPIANE

Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ka paraqitur njëherë një organizatë politiko-ushtarake revolucionare dhe të pavarur të shqiptarëve, e pastaj një Qeveri autonome popullore shqiptare, respektivisht një lëvizje apo një revolucion popullor shqiptar.



Osman D. GASHI

**E**mrat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit: Lidhja, Lidhja e Prizrenit, Lidhja Shqiptare, Lidhja Shqiptare në Prizren, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Lidhja Kombëtare, Lidhja e Sigurisë Kombëtare, Lidhja Shqiptare e Sigurisë Kombëtare, Lidhja Kombëtare e Shqipërisë, Besa. Kjo ka paraqitur njëherë një organizatë politiko-ushtarake revolucionare dhe të pavarur të shqiptarëve, e pastaj një Qeveri autonome popullore shqiptare, respektivisht një lëvizje apo një revolucion popullor shqiptar.

Karakteri i vërtetë i lëvizjes popullore shqiptare shihet më së miri nga memorandumimi i saj, drejtuar Anglisë, në mars të vitit 1878, ku ndër të tjera thuhet:



“... Në qoftë se Evropa do ta miratojë vetëvendosjen e sllavëve në shtete të pavarura apo autonome, është e qartë se shqiptarët nuk mund t’i lejojnë vetes, me kënaqësi, një administrim q

të kalbur dhe të keq, siç ishte ai nën të cilin ishin deri sot. Ata janë të bindur se Qeveria Osmane s’do dhe as që ka mundësi të na japë neve (shqiptarëve) një gjë (administrim) më të mirë. Shqiptarët, të cilët janë të vendosur t’i këputin zinxhirët që i kanë lidhur me Perandorinë Osmane, kërkojnë një Qeveri të ndarë, e cila do të jetë më shumë në harmoni me kërkesat dhe traditat e tyre; ata kërkojnë të drejtën për të hyrë në gjirin e familjes së madhe evropiane, të cilës i përkasin për nga raca dhe faretisnia. ...”

Ky petitionin është drejtuar kundër Paqes së Shën Stefanit, të dt. 30 mars 1878, në emër të Vilajetit të Kosovës, të cilin e ka nënshkruar Haxhi Ymer efendiu (Kryetar i Lidhjes së Prizrenit).

Koha nuk priste. Situata politike zhvillohej dhe vazhdonte gjithnjë në dëm të interesave shqiptare. Prandaj udhëheqja e Lidhjes Shqiptare u aktivizua edhe më shumë. U mor vendim që të ftohen “në një mbledhje të përgjithshme në Prizren, përfaqësuesit e të gjitha krahinave të Shqipërisë për të diskutuar mbi mbrojtjen e tokave shqiptare po që se aneksimi i tyre do të vendosej nga Kongresi i Berlinit. Mbledhja u caktua të bëhej më 10 qershor 1878.”

Lidhja ishte e prirë nga udhëheqësit e





denjë: Haxhi Ymer efendiu, Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi, Haxhi Zeka, Zija Prishtina, etj. Kësaj parie iu desh që të luftojë vazhdimisht në tri fronte: kundër Qeverisë Osmane, kundër fraksionit të djathtë të Lidhjes që përkrahte Sulltanin dhe Qeverinë Osmane, që u krijua në Kuvendin e qershorit, dhe kundër aspiratave të monarkive fqinje dhe të shteteve të mëdha imperialiste të Evropës. Një luftë e tillë nuk ishte e lehtë. Përkundrazi, siç do të shohim, ishte plot me rreziqe dhe pasoja të rënda.

Menjëherë pas mbajtjes së Kuvendit të përgjithshëm të Lidhjes së Prizrenit shpërthyen konfliktet e hapura dhe të ashpra mes Portës së Lartë dhe disa udhëheqësve shqiptarë që ishin ithtarë të sulltanit nga një anë, dhe të fraksionit të majtë të Lidhjes nga ana tjetër. Kështu, në gjysmën e dytë të gushtit 1878 Porta e Lartë dërgoi Mehmet Ali pashën për t'i vënë në zbatim nenet e Traktatit të Berlinit. Porse, shqiptarët progresistë në Gjakovë e vranë misionarin e Portës, Mehmet Ali pashën me suitën e tij, e cila përbëhej nga shqiptarët konserva-

torë (në fillim të shtatorit 1878).

Lidhja e Sigurisë Kombëtare kaloi në aksione të gjera. Kështu, Këshilli Qendror i Lidhjes, me seli në Prizren, i urdhëroi nën-komiteteve që të kujdesen për sigurinë e të krishterëve dhe të huajve, e në të njëjtën kohë të jenë të përgatitur për të marrë masa më vendimtare për të mirën publike. Ishte ky një përshkrim i shkurtër i vetëm një prej ngjarjeve të shumta që ndodhi asokohe.

Pjesëmarrësit e Kuvendit të Lidhjes së Prizrenit

Në vijim do t'i japim emrat e disa nga pjesëmarrësve të Kuvendit të Lidhjes së Prizrenit që kanë qenë në kuvendin e datës 10 qershor 1878 në Prizren.

**A**

• **Abdullah pashë Dreni - Gjakovë**  
• **Abdyl Frashëri - kryetar i komisionit të jashtëm - përfaqësues i lidhjes (në Evropë)**

• **Ahmet Koronica - Gjakovë**

• **Ali bej Gucia - Guci**

• **Ali bej Tirana**

• **Ali Ibra**

• **Ali pashë Draga**

**B**

• **Binak Alia**

**Ç**

• **Çelë Shabani**

**F**

• **Filip Doda**

**H**

• **Hasan pashë Tetova**

• **Haxhi Shabani**

• **Haxhi Zeka - Pejë**

**I**

• **Iljaz pashë Dibra - kryetar i kuvendit**

**J**

• **Jashar bej Shkupi**

**M**

• **Mehmet Vrioni - përfaqësues i lidhjes (në Evropë)**

**S**

• **Sali Jaha - përfaqësues i Rugovës**

• **Shuajip Spahiu apo Shaip Spahiu, nënkryetar i Lidhjes së Prizrenit**

• **Sulejman Vokshi - kryetar i komisionit për financa - Gjakovë**

**Sh**

• **Shaban bej Peja**

• **Shaban bej Prizreni**

• **Sheh Mustafa Tetova**

**Y**

• **Ymer Prizreni - kryetar i komisionit organizator të Kuvendit - Prizren**

**Z**

• **Zija bej Prishtina**

**Tragedia e një populli**

# ÇEÇENIA NËN TERRORIN RUS

**“Rusët donin ta shuanin përmendjen e popullit çeçen. Republika e Çeçenisë dhe Ingushetisë u fshinë. Fshatrat dhe emërtimet topografike kishin marrë emra të rinj rus. Shtëpitë muze që kujtonin persekutimet ishin zhdukur. Rusët i kishin rrafshuar për tokë edhe varrezat. Populli çeçen ishte zhdukur nga manualët shkollorë dhe nga enciklopeditë.” Jörg Baberowski**

**Ajni SINANI**

**A**utori Jörg Baberowski në një shkrim të tij me titull “Krimi i shekullit, lindja e luftës çeçene nga fryma e terrorit stalinist” përshkruan internimin e popullit çeçen nga ana e Stalinit dhe bashkëpunëtorëve të tij. Veç të tjerash ai nënvizon:

“Natën, ndërmjet 23 dhe 24 shkurtit të vitit 1944, Lavrent Berija, shefi i shërbimit sekret të Stalinit kishte dhënë urdhër për internimin e çeçenëve dhe të ingushitëve nga shtëpitë e tyre. Berija i raportonte Stalinit për fillimin e operacionit: ‘Sot, më 23 shkurt, me daljen e diellit kemi filluar me internimin e njerëzve.’ Një ditë më vonë, Berija raportonte përfundimin e operacionit. Internimi kishte shkuar ‘normalisht’ dhe ishin transportuar 352.647 njerëz me 86 trena.”

Baberowski shkruan se ishin internuar rreth gjysmë milionë çeçenë dhe ingushitë, që rusët i kishin internuar në Kazakistan dhe në Kirgistan. Në shtëpitë e braktisura prej çeçenëve ishin vendosur fshatarë të shpërngulur rusë dhe ukrainas dhe refugjatë që kishin humbur shtëpitë e tyre në vorbullën e luftërave, sikur çeçenët të mos kishin banuar asnjëherë aty.

Autori thekson se pas vdekjes së Stalinit, shumë çeçenë u kthyen ilegalisht në atdheun e tyre. Komunistët iu kishin ofruar çeçenëve një pjesë të Kazakistanit ku ata do të kishin autonomi, gjë që ata e refuzuan. Në vitin 1975 komunistët u detyruan të lejojnë kthimin e çeçenëve dhe rivendosjen e autonomisë së Çeçenisë dhe Ingushetisë.

Kjo ishte gjendja tragjike e çeçenëve gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

**Gjendja në Çeçeninë e sotme**

**Një numër i madh humanistësh dhe organizatash të ndryshme për të drejtat e njeriut anekënd botës kanë ngritur zërin e tyre kundër torturave të ushtruara nga SHBA në Ebu Gureib apo Guantanamo. Ndërkaq, kemi një heshtje të plotë ndaj masakrave dhe torturave jonjerëzore që po bëjnë Rusia e Putinit në një Ebu Gureib apo Guantanamo tjetër të quajtur Çeçeni.**

Për gjendjen e sotme në Çeçeni nuk flitet shumë. Opinioni ndërkombëtar bën sehir dhe nuk ndihet aspak i shqetësuar për atë që po ndodh atje. Shtypi apo mediat vizive

rrallëherë kujtohen që të pasqyrojnë realitetin e hidhur në Çeçeni.

Padyshim se është për t'u përshëndetur raporti i Human Rights Watch i publikuar në muajin nëntor 2006, pikërisht kur Komiteti i KB-së kundër torturimit kishte përfunduar vështrimin e vet kritik për Rusinë.

Raporti bën të ditur se torturat në burgje publike, ose të fshehta në Çeçeni po përhapen gjithnjë e më shumë në mënyrë sistematike.

HRW në dokumentin e tij të gjerë shkruan se janë mbi njëqind raste torturimi, gjë që lë të kuptohet se keqtrajtimi jonjerëzor në Çeçeni ushtrohet vazhdimisht.

Raporti prej 16 faqesh që mban titullin “Përhapja e torturimit në republikën e Çeçenisë” i është dërguar Komitetit të KB-së kundër torturimit. Dokumenti shqyrton torturimin johuman që iu bëhet të burgosurve nga ana e forcave çeçene pro-ruse dhe anëtarëve të policisë ruse.

Në punën hulumtuese që ka zgjatur nga prilli deri në shtator të vitit 2006, HRW ka vërtetuar 82 raste, ku forcat nën udhëheqjen e diktatorit rusofil Ramzan Kadyrovit i kanë burgosur njerëzit dhe kanë ushtruar dhunë ndaj tyre.

Hulumtimi i bërë përmend një numër burgjesh të paligjshme, së paku dhjetë sosh, dhe faktin se shumica e tyre gjenden në shtëpitë private të komandantëve regjionalë që janë lojalë ndaj Kadyrov-it, diktatorit besnik të Moskës.

Në raportin e HRW përmendet se për të marrë informata me rëndësi të burgosurit keqtrajtohen dhe ndaj tyre ushtrohet dhunë. Gjithashtu nënvizohet fakti se disa prej të burgosurve më pas lëshohen, kurse disa të tjerë detyrohen që t'u bashkëngjiten forcave të Kadyrov-it.



HRW ka dokumentuar dhe një numër rastesh ku në torturimin dhe keqtrajtimin e të internuarve nëpër burgje ka marrë pjesë edhe personeli i njërit prej shërbimeve informative ruse (ORB-2).

Të persekutuarit, sipas raportit të HRW, kanë thënë se i janë nënshtruar shokut elektrik, rrahjes me çizme, me shkop, me tel, kurse disa kanë treguar, se janë ndëshkuar, madje, edhe me zjarr. Gjithashtu mbi ta është ushtruar edhe presion psikik. Në raport theksohet se pushteti ka ndërhyrë shumë rrallë në mënyrë që të ndalohen apo të ndëshkohen ata që bëjnë torturime të tilla. Madje edhe atëherë kur viktimat kanë marrë guximin të bëjnë ankesë, prokurori dhe organet përgjegjëse kanë refuzuar që të nisin hetimin.

Orvatja e qeverisë ruse që ta mbajë të mbyllur Çeçeninë ndaj botës së jashtme, dhe që të mos ndëshkojë shkelësit e ligjeve të vet asaj, ka bërë që Çeçenia të shihet nga jashtë si një burg i madh rus. Rusia është treguar e vendosur që t'i mbajë sa më larg vëzhguesit e jashtëm ndërkombëtarë dhe është munduar që të pengojë vazhdimisht çfarëdo denoncimi të kasaphanës dhe shkeljeve flagrante që është duke ushtruar ndaj një populli të vogël e të pambrojtur.

Rusia nuk ka ngurruar që të përdorë në mënyrë të rreme edhe kartën e terrorizmit duke i akuzuar luftëtarët çeçenë për lidhje me Al Kaidën.

Është i pakuptueshëm hezitimi dhe mosgatishmëria e shteteve islame që nuk e ftojnë Rusinë që të marrë hapa konkretë për ndërprerjen e praktikimit të torturimit dhe gjenocidit që ajo po ushtron në heshtje ndaj çeçenëve.

Femra dhe pasojat e luftës

# Të dhunuarat, edhe pavarësia nuk i gëzon

“Për njeriun mund të mos ketë rrugëdalje në histori, për popullin rrugëdalje ka gjithmonë”. Rexhep Qosja

Emine A.VEZAJ

**H**istoriografia shqiptare gjer më sot ka lënë pa trajtuar shumë momente dhe ngjarje të rëndësishme, të cilat kanë lënë gjurmë të pashlyera në kujtesën e popullit shqiptar dhe që, në më të shumtën e rasteve kanë mbetur të pa prekura gjer më sot. Trojet shqiptare, në përgjithësi, dhe Kosova në veçanti, fituan gjatë shekujve rëndësi të jashtëzakonshme për mbretërit e sulltanët, të cilët dëshironin të dominonin dhe të ruanin influencën e tyre në Gadishullin Ballkanik. Por shqiptarët asnjëherë nuk lejuan të mposhten, edhe pse kjo u ka kushtuar gjithmonë. Edhe pse me dëme të konsiderueshme, si në njerëz ashtu edhe në të mira materiale, ajo ende mban epitelin e një vendi të pathyeshëm. Gjenocidi i fundit i serbëve në Kosovë u realizua mbi bazën e një plani të mirë-përcaktuar nga Beogradi. Dhunimi i grave, nënave, nuseve të reja ishte forma më tronditëse që preku ndjenjat e shqiptarit. Dhunimi është vepër penale që konsiderohet krim kundër njerëzimit. Sipas statutit të Tribunalit të Hagës (neni 5) dhunimet, që kryhen në konflikte të armatosura, qofshin këto ndërkombëtare apo edhe të karakterit lokal, konsiderohen krime kundër popullsisë civile. Në vështrimin “Dhuna seksuale si krim ndërkombëtar (“Fakti”, 12 e 13 Maj 1999) ekspertët e Tribunalit Ndërkombëtar për Krimet e Luftës theksojnë se aktet e dhunës seksuale trajtohen në kuadër të juridiksionit të ICTY (Tribunali Ndërkombëtar për Krimet e Luftës në Jugosllavi), dhe ICTR (Tribunali Ndërkombëtar për Krimet e Luftës në Ruhand). Ata me anën e shembujve të ndryshëm të dhunimeve e elaborojnë këtë çështje në mënyrë shkencore dhe juridike. Këta ekspertë potencojnë disa segmente të juridiksionit të të dy Tribunalëve Ndërkombëtare për Krime të Luftës të cilat, në statutet e tyre, dhunimin seksual e konsiderojnë si: krim kundër njerëzimit, gjenocid, shkelje të ligjeve të luftës, torturë etj. Për pasojë, një ndër format e regjimit serbo-sllav në Kosovë, ishte edhe dhunimi masiv i femrave shqiptare. Duke pasur parasysh se sunduesi tiran e dëshmoi antinjerëzoren e tij edhe në luftën e Bosnjës, në të cilën u dhunuan dhe persekutuan më dhjetëra,

qindra apo mijëra gra muslimane, të cilat u çnderuan në mënyrat më mizore, arrihet në konkluzionin se kjo formë e dhunës ka qenë e planifikuar. Pra, marrë në përgjithësi, lufta në Kosovë ishte edhe një vazhdim i një plani të mirë-përcaktuar në vazhden e krimeve të tij. Përdhunimet që janë bërë gjatë luftës në Kosovë nga forcat policore-ushtarake dhe paramilitare serbe kundër femrave shqiptare, ishin vepra me karakter poshtërues, politik, hakmarrës, dhe qëllimi kryesor ka qenë thyerja dhe poshtërimi i shqiptarit në aspektin moral duke dhunuar femrën, motrën, grua, nënën, vajzën e tij, etj... Dhe ja lufta e Kosovës mbaroi. Tash mbetet për t'u përcaktuar saktë kjo tragjedi, që shënoi edhe një datë të re në analet e historisë. Por shtrohet pyetja se sa kemi bërë në këtë drejtim ne për t'i lehtësuar gjendjen në të cilën kanë kaluar këto femra? Mund të themi se shumë pak ose asgjë, ngase janë publikuar rrëfime të ndryshme, natyrisht pa të dhëna konkrete të rasteve, por marrë në përgjithësi të gjitha këto hulumtime janë bërë nga organizata dhe shoqata të huaja, e po ashtu edhe nga organizata vendase. Sipas Luljeta Selimit, e cila ka bërë një punë të madhe në këtë drejtim duke hulumtuar raste të këtij lloji, statistikave e dhunimit në Kosovë mund të radhiten kështu: Në Kosovë, numri i femrave të dhunuara sipas statistikave kap shifra të ndryshme varësisht nga organizatat e ndryshme të cilat kanë bërë hulumtime në këtë drejtim. Ato shifra sillen nga dy mijë deri në dhjetëra mijëra! Sipas Organizatës Joqeveritare “Jeta në Kastriot” mund të flitet për 2018 femra të dhunuara për të cilat përveç dëshmimeve gojore, video-xhirimeve, dëshmimeve me shkrim dhe fotografive ekzistojnë edhe raportet e mjekëve: gjinekologë, infektologë, neuropsikiatër, si dhe raportet mujore të të gjithave së bashku për ta konstatuar gjendjen e tyre momentale, po ashtu diagnostat e secilës veç e veç bashkë me terapinë e përdorur. Moshë e këtyre femrave është kryesisht e re duke filluar nga 14 e deri të 44 vjeç. Shohim se struktura e të dhunuarave ka qenë e shumëllojshme. Qytete e Gjakovës, Pejës dhe Drenicës janë vendet ku dhunimet e grave e të vajzave kanë qenë më të shumta. Sipas disa prej të dhunuarave ushtarët serb merrnin grupe vajzash dhe i dhunonin me orë e deri me ditë të tëra. Shumë herë, viktimat pasi

dhunoheshin sistematikisht, vriteshin. Gjithashtu një karakteristikë tjetër e atij regjimi ka qenë edhe ajo se dhunimi është bërë në forma të ndryshme. Dhunimi është bërë në mënyrë masovike. Një ngjarje të tillë kemi mundur ta dëgjojmë nga një grua, e cila tregon: derisa vëllain tim 12 vjeçar filloi ta rrihte policia, unë u mundova që ta ndihmoj. E kishim një vëlla pas nëntë motrave, por ndodhi më e keqja ata më morën mua dhe më çnderuan në prani të babait, nënës, motrave dhe burrit. Këtë e shihte e gjithë kolona, por edhe familjarët e mi, thotë ajo grua e dhunuar. Pra dhunimi është bërë edhe në prezencën e të afërmeve të të dhunuarave. Tmerri nuk përfundon me kaq. Kemi mundur të gjejmë edhe raste kur viktima pasi është dhunuar është mbytur për të humbur gjurmët, dhe marrë në përgjithësi, dhunimi është kryer mbi të gjitha shtresat e femrave shqiptare. Në vazhdim do të sjellim rrëfimin e një gruaje të dhunuar, që është shkëputur nga libri i Luljeta Selimit, “Rrëfimet e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë”. Tmerri në ditën e “gënjeshtrove” S. S. nuk dëshironte ta fillonte rrëfimin para nënës së saj. Por kur e ëma doli, S. S. e filloi rrëfimin...“Nuk kam menduar kurrë se njeriu mundet të duroj kaq shumë. Edhe për vete, por edhe për të tjerët, në raste të tilla kam menduar se do t'i dorëzoheshin vdekjes. Unë në duart e serbeve rashë më 1 prill, në ditën kur shqiptarët po dëboheshin masovikisht. Kur me ndanë nga familja, mendoja vetëm për ata, por kur më dërguan në vendin ku ishin strehuar policët dhe në tavolinën e përgjakur pashë flokë femrash, thonj dhe veshje femrash, e dita se çka do të më ndodhte. Më nuk shpresoja se e kam dikë në botë, dhe çka do të ndodhte me të afërmit e mij. E kisha vetëm hallin tim. Dhe, kur unë po mendoja dhe po frikësohesha se çka do të ndodhë me mua, më thirri një nga ata që e udhëhiqte atë grup kriminelësh. Aty, mbi tavolinën e tij, kishte raki dhe sytë e tij të skuqur e të çartur i tregonin të gjitha. Në gjoks kishte një zinxhir me plot stoli dhe më tej në një qoshe të strehimores kishte përplot veshje femrash. “Këtu duhet të zhvishesh e pastaj ta shoh a je për mua, për eprorët ose për ushtarët”, më tha ai në gjuhën serbe derisa po pinte raki. Unë po rrija aty, gjoja se nuk e kuptova, por ai ma ktheu këtë urdhër në shqip. E shikova dhe, edhe pse

e frikësuar i thashë “jo”. Ai hodhi shishen me raki dhe u ngrit si i tërbuar. “Mua askush s’guxon të ma thyen urdhrin, unë jam Dragan Spasiq, unë jam njeriu që me dorën time kam prerë mbi 50 shqiptarë e ti, kuçkë!”- klithte ai si i marrë. “Qenka rruga e vdekjes kjo”, mendova me vete dhe kur ai më goditi me kondak pushke nuk qava. E shihja gjakun që me rridhte nga hundët por nuk më dhimbsej jeta, doja të vdisja e jo të bija në dorën e tij. Por, pas pak, ai u qetësua dhe i urdhëroi ushtarët e tij të më zhveshin. O Zot, nuk mund ta marrësh me mend se si ndihesh. “Duhet të vallëzosh, ec vallëzo” – më thoshte, e unë isha kërrusur e ulur, që të mos shihej trup i lakuriq. “E sheh atë trup atje, do të ta bëj më zi” – më thoshte ai, e unë nuk e kisha vërejtur trupin e një vajze të bërë copë-copë, në afërsi të rrobave të viktimave, të cilave ata ua kishin bërë si mua. Nuk fola, por dy nga ata erdhën dhe me lidhën për tavolinën e përgjakur. M’i lidhën këmbë e duar dhe më shikonin si bisha. Dikur ai, shefi i tyre, u zhvesh dhe filloi të më çnderojë, të tjerët qeshnin e flisnin çka u tekej, shikonin e talleshin, derisa unë përpëlitesha me vdekjen. Ai u largua vetëm kur u ngop, për të vazhduar më tej edhe disa të tjerë. E njëjta gjë më ndodhi disa ditë me radhë dhe pas disa ditësh më hodhën ashtu lakuriqë buzë rrugës, ku kishte edhe shumë kosovarë të tjerë, që po iknin për në Shqipëri. Vetëm kur vëreja se një grua po më mbulonte, pashë se trupi im ishte i prerë me thika në shumë vende dhe se në trupin tim kishte të vizatuara disa kryqe dhe shenjat e simbolit të kryekriminelit Millosheviq. “Mos më merr, më le të vdes, të lutem” – i thashë asaj, por ajo më pëshpëriti ngadalë. Edhe pak rrugë kemi deri në


tokën nënë, ja e sheh rrugën”, përpiquej ajo të më ndihmonte, kurse unë e shikoja rrugën që më dukej se po ecte me mua dhe shpresoja se po vdisja, sepse për mua ajo ishte dhe mbeti rruga e vdekjes.

Po ashtu edhe e përditshmja “Flaka” e datës 24 Maj 1999 ka shkruar për raportin e publikuar nga OSBE, për krimet dhe gjenocidin serb në Kosovë, ku thuhet se janë grumbulluar 1400 dëshmi për krime lufte e dhunime në Kosovë. Në këtë raport thuhet se dëshmitë janë grumbulluar nga gratë dhe vajzat e reja shqiptare të cilat rrëfejnë për veten e tyre (anonime) apo për shoqet e tyre dhe të afërmet që kanë përjetuar dhunime nga pjesëtarët e forcave serbe.

Pra, raste të tilla kemi shumë në Kosovë, madje mënyra se si këto gra i tregojnë rrëfimet e tyre janë shumë tronditëse dhe skajshmërisht të dhimbshme. Nga qyteti në qytet dhe nga fshati në fshat, përjetimet janë të ndryshme. Ato që kanë përjetuar këtë tragjedi të tmerrshme, tregojnë se si kanë qenë të shtrënguara t’u dhurojnë të holla dhe ar paramilitarëve serb, dhe pasi i kanë dhënë këto të holla ato përsëri janë dhunuar. Një tregim që kisha rastin ta lexoj në këto rrëfime, dhe që ka qenë ndoshta edhe më tronditëse ishte se si një vajze të re i ishte mbytur nëna dhe vëllai në praninë e saj. Ajo tregon: ‘Pastaj mua më morën me vete më dhunuan, dhe në trupin tim është shpuar i gjithë gjoksi më cigare, më pastaj më bënë kryqe serbo sllave, dhe gjithashtu më hoqën edhe thonjtë nga gishtërinjtë.’ Ky rrëfim mund të jetë vetëm një skenar i kësaj tragjedie. Kosova ka përjetuar shumë e më shumë. Këto femra, edhe pas gjithë këtyre përjetimeve, që sa herë zbulojnë trupin i shohin gjurmët e dhunës së ushtruar mbi to,

prapë se prapë, i mban të forta shpresa se një ditë Kosova do t’i gëzojë me pavarësimin e saj, për të cilën ato sakrifikuuan edhe nderin e tyre. Vlen për t’u përmendur se këto gra që ishin pre e torturave barbare të tigrave të Serbisë asnjëherë nuk u përlulën para armikut. Gruaja shqiptare e ka dëshmuar gjithmonë veten në të kaluarën, por ajo diti ta dëshmojë edhe sot. Edhe pse në trupin e saj mban gjurmë tmerrri nga më të ndryshmet, ajo është e pathyeshme pasi e mban shpresa se Zoti do ta shpërblejë. Besimi në Zotin Një, në çdo frymëmarrje dëshmohej nga këto gra. Ato do të kenë shpërblimin e tyre nga i Lartmadhëruari. All-llahu xh.sh. thotë: “...E kush i detyron me dhunë të bëjnë atë, All-llahu i falë ato pas atij detyrimi. All-llahu fal dhe është Mëshirues.” En-Nur:33.

Para se ta përmbyll këtë temë, dua të apeloj te të gjithë për detyrën që kemi ndaj kësaj shtresë të shoqërisë duke bërë përpjekje të vazhdueshme për rikthimin e tyre në binarë e jetës normale. Sepse këto gra, motra dhe nëna që kanë përjetuar këtë tragjedi nuk janë të vetme në këtë aspekt, por jemi edhe ne bashkë me to, sepse dhunimi që është kryer mbi to është pjesë e një lufte të përlyer, që ka shkaktuar dhimbje të natyrave të ndryshme: dikë e ka marrë plumbi, dikë e ka gjymtuar granata, dikush është masakruar, prandaj edhe dhimbja e këtyre femrave duhet llogaritur si dhimbje të përgjithshme. Por s’duhet harruar se ndjenjat e femrës janë më të buta dhe ajo shpesh është e pafuqishme të përballet me sfidat. Prandaj ne duhet t’i ndihmojmë vazhdimisht të gjitha ato gra që kanë humbur më të dashurit e tyre, duhet t’i ndihmojmë ato gra që për shkak të dhunimit kanë mbetur larg ëndrrës për tu bërë nënë, të përpiquej t’i ndihmojmë ato gra që t’i harrojnë plagët e dhunimit që u janë bërë në praninë e familjarëve të tyre. Nderi është dhuratë nga Zoti, dhe ai u është grabitur në mënyrë mizore. Dhe ne për t’ua kthyer nderin, duhet t’i nderojmë dhe t’i respektojmë ato. Është më së e vërtetë se rruga e lirisë s’është e shtruar me lule, por me vuajtje e mundime të gjata, prandaj ne mundin e tyre duhet ta konsiderojmë si pjesë përbërëse të veprimtarisë sonë, duke i mundësuar edhe kësaj shtrese të shoqërisë që të rikthehet në jetën normale dhe të integrohet në jetën normale pa brengat e së kaluarës. Të mundohemi që këtyre femrave t’u bëjmë një trajtim më të mirë, në mënyrë që ato t’i harrojnë plagët e dhunimit që mbajnë në shpirtat e tyre. T’i ndihmojmë familjarët e grave të dhunuara që gratë, nuset, vajzat ta tejkalojnë me lehtësi thyerjen shpirtërore që përjetuan gjatë luftës së fundit.



Histori Islame

# Migrimi i muslimanëve

**Në ato kohëra njeriu nuk e kishte të lehtë të shpërngulej. Si duket vendi më i përshtatshëm për emigrantët e parë muslimanë ishte Abisinia, edhe pse rruga për të shkuar në këtë vend ishte me shumë rreziqe. Por ia vlente që të merrej parasysh edhe rreziku i udhëtimit për arsye se atje ata do të stabilizoheshin më mirë. Ajo që e kishte shtyrë Muhammedin s.a.v.s. që t'i orientonte muslimanët e parë që të migronin në këtë shtet, ishte divergjencia midis të krishterëve në Perandorinë Bizantine.**



**Muhamed Jusufi  
– KAJOLLI**

**S**i popujt e Lindjes së Mesme ashtu edhe shumë popujt të tjerë të botës kishin njohuri për Shpalljet Hyjnore. Menjëherë pas ardhjes së Isaut a.s., popujt që besonin në fetë qiellore ishin në pritje të dërgesës së fundit qiellore. Kjo shpallje erdhi pas disa shekujsh, në Gadishullin Arabik. Do të ishte krejt e natyrshme që ata që e besuan Muhammedin si pejgamber të mendonin se do të ishin të privilegjuar, ashtu si apostujt-ensarët e Isaut a.s., të cilët kishin përjetuar mrekullitë e tij. Por programi i kësaj dërgese ishte krejtësisht ndryshe nga ato që ata ishin mësuar të dëgjonin më herët. Dërgesa e Muhammedit s.a.v.s. për jobesimtarët nuk dukej aspak qiellore, sepse ata mundoheshin t'i përshtateshin realitetit që krijohet. Pra, ata përballeshin me realen. Asgjë nuk vërehej, asnjë ndryshim mbinatyror nuk krijohet tek ata brenda shoqërisë që i rrethonte. Nuk dihet që ndonjë nga besimtarët e parë të kishte braktisur besimin e tij, megjithëse vuajtjet e përditshme sa vinin e rëndoheshin çdo ditë e më shumë. Kemi theksuar më parë se nga torturat e ndryshme kishin filluar të flijoheshin edhe viktimat e para. Muslimanët i pranonin të gjitha llojet e torturave, por ata nuk pranonin assesit të riktheheshin në politeizëm ose injorancën e mëhershme.

Pra, ata nuk ishin aspak njerëz të luhatshëm, pasi si duket kishte ardhur koha që ata gradualisht ta kuptonin se Programi Qiellor nuk ishte i ngjashëm me programet e tjera. Revelata që i shpallej Muhammedit s.a.v.s. nuk ngjasonte me Torën ose Ungjillin, por ajo rrethohej sipas nevojës dhe në ko-

hën e duhur. Secila germë ose fjali kishte shkakun e vet. Kur'ani plotësohej qetësisht me një Urtësi të Lartë dhe në mënyrë graduale. Për këtë arsye jobesimtarët filluan të mendojnë se Muhammedi ishte përshkrues dhe analist i mirë i ngjarjeve.

Edhe pse Muhammedi s.a.v.s. nuk mernte asnjë iniciativë pa lejen Qiellore, megjithatë ai dhe shokët e tij herë pas here konsultoheshin dhe bënin analiza të ndryshme. Muuslimanët po hynin në gjysmën e parë të vitit të pestë të revelatës hyjnore. Disa rrëfime që filluan t'iu shpallëshin atyre në 'Suren e Shpellës' sikur po i përgatiste ata psikikisht që t'i braktisnin vendbanimet e tyre. Si duket Muhammedi s.a.v.s. nuk ishte akoma i sigurt se besimtarët duhej të shpërnguleheshin përpara tij, sepse në takimin që kishte pasur me të krishterët Neufel, ai e kishte paralajmëruar se vetë i Dërguari All-llahut do ta braktiste vendin. Por pas pak kohësh, u rrethoi ajeti kur'anor i cili e qartësoi këtë dilemë. Ky ajeti i la të lirë që të migrojnë të gjithë ata që donin ta bënin një gjë të tillë sepse toka e All-llahut është e gjerë, ndërsa për ata që do të duronin dhe do të vazhdonin të qëndronin me Muhammedin s.a.v.s., ai premtoi se do të shpërblehen pa masë nga Zoti.

Meqenëse leja për migrim u dha atëherë diskutimi se cili vend do të ishte më i përshtatshëm ishte i pashmangshëm. Ne nuk kemi ndonjë të dhënë të dokumentuar rreth diskutimit, por vetë fakti se Abisinia [Etiopia e sotme] u zgjodh nga Pejgamberi s.a.v.s. si vendi më i përshtatshëm për strehim, na jep ne të kuptojmë se muslimanët kanë diskutuar rreth këtij vendimi. Gjithashtu është e qartë se ata kanë pasur njohuri mbi ngjarjet dhe politikën e rajonit.

**Pse u zgjodh Abisinia?**

Në kohën e Pejgamberit të Zotit, Muhammedit s.a.v.s., në Abisini sundonte mbreti Nexhashi – Negrusi. Feja zyrtare e atij vendi ishte krishterizmi monofizitist.

Nëse i hedhim një vështrim të shkurtër situatës politike të kohës së atyre viteve shumë të vështira për muslimanët, themi se Muhammedi s.a.v.s. nuk do të preferonte që të shpërngulur të strehoheshin në territoret e perandorisë persiane, sepse ata nuk ishin monoteistë. Zjarrputistët nuk kishin shumë dallim nga politeistët e Gadishullit Arabik dhe një pjesë e jugut të këtij gadishulli ishte sferë e interesit politik të persëve. Si një superfuqi e kohës, ajo kishte mundësi t'i dëbonte ose edhe t'i asgjësonte muslimanët e migruar dhe nuk do të merrej vesh fare se çfarë ndodhi me atë grup të vogël beduinësh. Kështu do të kishte vepruar çdo udhëheqës, ashtu sikurse udhëheqësi shqiptar nuk do t'iu sugjeronte të shpërngulurve shqiptarë të Kosovës të viteve të 90-ta, që të migronin në Greqi. Ne e dimë shumë qartë se në atë kohë grekët mbronin interesat serbe, dhe se gjithashtu politika globale harmonizohej midis tyre. Më vonë u vërtetua se Muhammedi s.a.v.s. kishte pasur të drejtë që nuk iu kishte sugjeruar muslimanëve që të shpërnguleheshin në këtë vend, sepse pas disa vitesh kur Muhammedi s.a.v.s. i shkroi letër Kirsasë – mbretit të Persisë, për ta pranuar Islamit, ai e copëtoi letrën dhe e mbyti të dërguarin special të tij s.a.v.s.

Po ashtu Muhammedi s.a.v.s. nuk preferoi as mbretëritë arabe të Hiras dhe Gatafanit, në veri të Gadishullit Arabik. Këto mbretëri ishin shtete vasale dhe herë binin në duart e bizantinëve, e herë



në duart e persianëve. Këto dy mbretëri ishin zona tampone midis këtyre dy superfuqive të botës. Analoge me këtë situatë do të ishte, marrim për shembull, një lëvizje reformiste gjithëshqiptare, që do të kërkonte nga aktivistët e saj që të strehoheshin në Kosovën e shekullit XX-të, kur ajo vetë ishte e pushtuar nga sllavët që ishin të uritur për toka!?

“Nëse do të shkonin në tokat e Sham-it, jo që konsiderohej larg, por rreziku ishte edhe gjatë rrugëtimit. Gjithashtu perandoria bizantine kishte marrëdhënie të mira ekonomike me arabët e shkretëtirës”.

Prandaj Muhammedit s.a.v.s. i duhej të ishte shumë i saktë në marrjen e vendimit për shpërnguljet e para. Në ato kohëra njeriu nuk e kishte të lehtë të shpërngulej. Si duket vendi më i përshtatshëm për emigrantët e parë muslimanë ishte Abisinia, edhe pse rruga për të shkuar në këtë vend ishte me shumë rreziqe. Por ia vlente që të merrej parasysh edhe rreziku i udhëtimit për arsye se atje ata do të stabilizoheshin më mirë. Ajo që e kishte shtyrë Muhammedin s.a.v.s. që t'i orientonte muslimanët e parë që të migronin në këtë shtet, ishte divergjencia midis të krishterëve të Perandorisë Bizantine.

Komentatorja mbi problemet fetare Karen Armstrong kujton aleancat e Perandorisë Bizantine kështu: “Perandoria e krishterë e Bizantit, kishte bërë Abisininë, Etiopinë e sotme, një shtet vasal, e cila u konvertua në një formë heretike të kristianizmit të njohur si monofisitizëm, që ruante pikëpamjen se Krishti kishte vetëm një natyrë, atë hyjnore. Bizanti i persekutonte heretikët brenda perandorisë, por ishte i kënaqur t'i përdorte ata jashtë saj, për zgjerimin e ambicieve perandorake. Duke u futur në Abisini, Bizanti inkurajoi sunduesin e saj Negusin-Nexhashiun, t'i infiltronte në Jemen që ta fuste atë nën sovranitetin e Kostandinopojës”.

Kjo na kujton se marrëdhëniet midis tyre nuk ishin të mira. Në këto kushte strehimi i tyre në Abisini do të ishte shumë më i sigurt se sa në vende të tjera të rajonit. Natyrshëm lind pyetja se a ka pasur njohuri kaq të hollësishme për këto divergjencia Muhammedi s.a.v.s.? Nëse logjikojmë saktë dhe me mendje të kthjellët, si edhe duke pasur parasysh kushtet e informimit të asaj kohe, nuk mund të besojmë se ai ka pasur dijeni kaq të hollësishme. Por të qenët e tij i dërguar i All-llahut ndryshon çdo gjë, dhe këtu nuk ka vend për analiza logjike.

Sidoqoftë i Dërguari All-llahut s.a.v.s. ju tha atyre se atje keni një mbret të drejtë

dhe zemërgjerë, si dhe se ai vend është i begatë. Sipas një versionit, emigrantët e parë ishin dhjetë meshkuj dhe katër gra, ndërsa sipas një versionit tjetër, ishin dymbëdhjetë meshkuj e katër gra. Prijës i këtij grupi, ishte Osmani, i biri i Medhun-it. Në këtë grup ishte edhe dhëndri i Muhammedit s.a.v.s., Osmani i biri Affan-it me gruan e tij, që më vonë do të bëhej halifi i tretë. Ky ishte martuar me vajzën e dytë të Pejgamberit – Rukijen. Meqenëse siguria e tyre ishte në rrezik, këta udhëtuan natën në heshtje të plotë dhe arritën të kapin tragetin para se të vinin pabesimtarët. Pasi ata arritën në Abisini, shoqëria e atij vendi i mirëpriti dhe i strehoi ashtu siç ju kishte thënë i Dërguari i All-llahut.

Muhammedi s.a.v.s., kishte ngelur në Mekë me një numër të vogël muslimanësh të palodhur dhe gjithnjë në shërbim të së vërtetës. Historianët e jetës së Muhammedit s.a.v.s., na përcjellin një rast i cili tregon se ndërsa ai po lexonte me zë të lartë Kur'ani Kerimin në oborin e Qabesë, leximi tij i mahniti të pranishmit sa që kur ai lexoi ajetin e sexhde ra në sexhde (duke vënë ballin në tokë) dhe të gjithë të pranishmit ranë në sexhde edhe pse nuk ishin besimtarë. Kjo ngjarje kishte ndodhur pak muaj pasi ishte shpërngulur grupi i parë. Ky veprim ishte keqinterpretuar në Abisini, pasi atje muslimanët u informuan se të gjithë mekkasit e kishin pranuar Islamin me përjashtim të një numri të vogël. Kështu ata u kthyen menjëherë pasi dëgjuan lajmin e ‘gëzueshëm’. Por disa orë para se të arrinin në Mekë, ata e kuptuan se ai lajm nuk kishte qenë i vërtetë. Jo të gjithë pjesëtarët e këtij grupi u kthyen prapë në Abisini, disa prej tyre vendosën të qëndrojnë përsëri në

shtëpitë e tyre pasi siguruan mbrojtjen e ndërmjetësuesve.

## Migrimi i dytë

Si duket lajmi rreth muslimanëve u përhap shpejt në Gadishullin Arabik. Mendoj se këtë shërbim muslimanëve ua kishin bërë vetë politeistët, të cilët kishin propaganduar në dëm të Muhammedit s.a.v.s. në kohën e haxhit. Po afrohej edhe haxhi i dytë dhe Muhammedi s.a.v.s. do ta vazhdonte të takohej me haxhinjtë e ri. Numri i muslimanëve po rritej dita ditës, por edhe torturat sa vinin e shtoheshin. Pas afro gjashtë ose shtatë muaj prej se ishte shpërngulur grupi i parë, po përgatitej të shpërngulej edhe grupi i dytë. Muhammedi s.a.v.s. kishte parapëlqyer që në këtë grup të shkonin sa më shumë anëtarë të rinj të cilët sapo e kishin pranuar fenë. Ky grup kishte 83 meshkuj dhe 18-të ose 19-të gra duke mos llogaritur fëmijët e tyre. Kryesues i këtij grupi ishte Xhaferi, i biri i Ebi Talib-it i cili e mbrojti këtë grup nga përgënjeshtimet e të dërguarve mekas: Amr ibn Asi (emër që do të dëgjohet shpesh pas vdekjes së Muhammedit s.a.v.s.) dhe Abdullah ibn Ebi Rebia, të cilët iu ankuan mbretit Nexhashi për ikanakët e tyre. Pas një debati të gjatë mbreti Nexhashi e kuptoi se shoqëria mekase ishte duke i persekutuar besimtarët e fesë isalme. Ai e kuptoi se dallimi midis besimit që ai kishte dhe predikimit të Muhammedit s.a.v.s. ishte shumë i vogël. Edhe pse kishte raporte shumë të mira me parinë mekase, ai përfundimisht dha urdhër që të shpërngulurit ta ndienin veten si në shtëpinë e tyre.

Muslimanët që qëndruan në Mekë me siguri që do të persekutoheshin edhe më shumë. Të tërbuar nga mossuksesit tyre në Abisini, ata filluan të bëjnë presion disa herë radhazi mbi axhën e Muhammedit s.a.v.s. që t'ua dorëzojë nipin e tij. Por sa herë që ktheheshin nga ai, tërboheshin edhe më shumë sepse axha i tij qëndronte i pa luhatur.

Në ato kohë shumë të vështira për vendasit muslimanë, tri ditë pasi e kishte pranuar fenë islame guximtari i pashembullt Hamzai, njëri nga xhallarët e Muhammedit s.a.v.s., menjëherë në anën e muslimanëve kalon edhe një trim tjetër, Omeri i biri Hatab-it, halifi i dytë i ardhshëm i shtetit musliman.

Disa emigrantë, me të dëgjuar se Hamzai dhe Omeri kishin pranuar fenë, u kthyen menjëherë nga Abisinia për t'i ndihmuar muslimanët e Mekës në qëndresën e tyre.



NË NUMRIN TJETËR – IZOLIMI TOTAL.

Dhuna në familje

# Viktimat dhe abuzuesit u përkasin të gjitha grupeve sociale, ekonomike dhe arsimore

Të drejtat e njeriut janë të drejtat që çdo njeri i ka dhe i gëzon thjesht për shkak se ai është qenie njerëzore. Ato bazohen në parimin themelor se të gjitha qeniet njerëzore kanë një dinjitet njerëzor të trashëguar dhe se ata janë të barabartë në gëzimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore pavarësisht nga raca, ngjyra, gjuha, origjina kombëtare, mosha, apo besimet politike ose fetare.

**Arber ZEKA**

**R**astet e abuzimit në familje janë duke u rritur vazhdimisht pothuajse në çdo rajon dhe në çdo qytet. Vetëm gjatë 6 muajve të fundit janë paraqitur më tepër se 600 raste të dhunës në familje (sipas Shërbimit Policor të Kosovës), dhe janë sa e sa raste të tjera të cilat nuk janë paraqitur fare në polici. Në shumicën e rasteve viktimat të dhunimit familjar janë gratë, por nuk duhet harruar se as fëmijët nuk kursehen nga ky keqtrajtim, që përveç dëmit fizik, shkakton edhe probleme të shumta psikike.

Gjendja e keqe ekonomike dhe mos zbatimi i të drejtave njerëzore janë arsyet kryesore që bëjnë që në Kosovë të ushtrohet dhuna, posaçërisht ndaj grave (Rrjeti i Grave të Kosovës). Por tani më një gjë dihet fare mirë: nëse ndonjëri nga anëtarët e familjes vuan nga depresioni, sigurisht që kjo do të sjell dhunë në familje. Kjo për arsye se depresioni ka nevojë të çlirohet, dhe njeriu nuk mund të gjejë vend më të mirë që ta çlirojë depresionin e tij në mënyrë të pa turpshme se familja e tij, ku ai ushtron dhunë mbi pjesëtarët e saj e sidomos mbi gruan.


Çdo ditë, gra në të gjithë vendin janë viktimat të llojeve të ndryshme të abuzimit: rrahje dhe brutalitet në shtëpi, ngacmim seksual dhe kërcënim në punë, martesat me detyrim, trafikim seksual, prostituim i detyruar, etj.

Dhuna kundër grave është një element i pa barazisë ndërmjet grave dhe burrave, dhe përbën një formë diskriminimi kundër grave.

Studimet tregojnë se gratë dhunohen më tepër nga partnerët e tyre më të cilët jetojnë: ose të martuar zyrtarisht ose në bashkëjetesë, por nuk mungojnë as abuzimet nga pjesëtarët e tjerë të familjes: nga babai, nëna, i biri, e bija, vëllai, motra apo nga pjesëtarë të tjerë.

Të drejtat e njeriut janë përcaktuar më ligje që e mbrojnë njeriun nga veprimet që bien në kundërshtim me dinjitetin njerëzor dhe liritë elementare. Të drejtat e njeriut janë të drejtat që çdo njeri i ka dhe i gëzon thjesht për shkak se ai është

qenie njerëzore. Ato bazohen në parimin themelor se të gjitha qeniet njerëzore kanë një dinjitet njerëzor të trashëguar dhe se ata janë të barabartë në gëzimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore pavarësisht nga raca, ngjyra, gjuha,



origjina kombëtare, mosha, apo besimet politike ose fetare (Karta e Kombeve të Bashkuara, Neni 55 (c)).

## Kush abuzohet më së shumti

Të dhënat studimore tregojnë se, në përgjithësi, viktimat dhe abuzuesit u përkasin të gjitha grupeve sociale, ekonomike dhe arsimore, por rreziku më i madh është tek ato me arsim të ulët dhe gjendje të dobët ekonomike.

Po ashtu edhe gratë që marrin rolin e burrit në familje shpesh keqtrajtohen nga të tjerët duke mos qenë në gjendje të përmbushin rolin e burrit (shefit) të familjes.

Ndërsa për sa u përket burrave, të gjithë mund të jenë abuzues qofshin të punësuar apo të papunësuar. Edhe pse përqindja më e madhe u takon atyre që kanë shkollë tetëvjeçare, megjithatë nuk përjashtohen edhe rastet kur ata kanë arsim të lartë. Po ashtu, abuzues mund të jenë si ata që kanë probleme ekonomike, ashtu edhe ata që kanë një gjendje të qëndrueshme ekonomike.

Dhuna është e lidhur më idealet e tyre tradicionale të burrërisë, ose më idealet e imagjinatës që u prodhon truri i tyre.

## Ligji dhe qeveria

Vërehet një ndryshim pozitiv, por procesi është shumë i ngadaltë, dhe praktika mbetet mbrapa ndryshimeve ligjore pozitive të drejtuara për parandalimin dhe ndëshkimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave.

“Dhuna kundër grave është ndoshta dhunimi më i turpshëm i të drejtave të njeriut. Ajo nuk njeh kufij gjeografikë, kulturorë apo pasurorë. Për sa kohë që vazhdon, nuk mund të pretendojmë të bëjmë progres drejt barazisë, zhvillimit dhe paqes.”

Kofi Annan, ish Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Gati të gjitha vendet kanë ligje kushetuese që e ndalojnë diskriminimin në bazë gjinore dhe garantojnë barazinë përballë ligjit për të gjithë shtetasit, pavarësisht nga seksi. Kushtetuta e ndalon torturën dhe trajtimin jo njerëzor dhe mizor. Mekanizmat dhe rrugët për barazinë gjinore janë kudo në procesin e ndërtimit. Megjithatë të drejtat e njeriut e gjegjësisht të grave nuk janë zbatuar në mënyrë të mjaftueshme dhe nuk janë zhvilluar akoma mekanizmat mbrojtës

efikas.

Ajo çfarë duhet të bëjë një qeveri, për sa i përket ligjeve që mbrojnë familjet dhe çdonjërën pjesëtar të saj, është:

- Qeveritë duhet ta bëjnë dhunën në familje vepër penale.
- duhet ta bëjnë incestin vepër penale.
- duhet ta bëjnë përdhunimin në martesë vepër penale.
- duhet ta bëjnë çdo akt seksual të pavullnetshëm, madje edhe kur viktimat nuk ka rezistuar fizikisht, vepër penale dhe duhet të kujdesen që veprimet të tilla të ndiqen penalisht me sukses.
- duhet të rishikojnë ose shtojnë sanksionet, aty ku është e nevojshme, për sulme dhe rrahje të qëllimshme të kryera brenda familjes.
- duhet të miratojnë ligje të posaçme penale kundër gjurmimit.

Shumë qeveri në botë e kanë një ligj të tillë, prandaj edhe qeveria jonë do të ishte mirë të kishte diçka të ngjashme me qeveritë e suksesshme botërore.

Viktimave duhet t'u jepet mundësia që të kërkojnë mbrojtjen për të evituar dhunën si pasojë e së cilës ato janë viktimat.

Qeveritë duhet të adoptojnë legjislacion specifik për të përjashtuar “mbrojtjen e nderit”.

## Dhuna emocionale dhe psikike që i bëhet viktimës:

Poshtërim si: fyerje, sharje, nënvlerësim, lëndim apo të bërit për t'u ndier e pavlefshme, bëritje, zënie, thyerje pjatash, ngacmime, xhelozë, alkool, etj.

Izolim: kufizim i lëvizjeve dhe komunikimit me miqtë dhe familjen.

Kërcënime, shantazhe dhe tmerrime  
Fjala e tij duhet të jetë e fundit

## Format e dhunës fizike që i bëhen viktimës:

Shuplaka në fytyrë

Rrahje

Goditje me objekte

Goditje me shkelma

Përndrydhje krahu, shkulje flokësh

Kafshim

Fikje e cigares në trupin e gruas

Përdorim i thikës ose pistoletës



Leximi i tekstit

# POLISEMIA TEKSTORE

**Autori përmes simbolikës, para së gjithash jep mesazhin e zgjimit të vetëdijes, çdo herë duke iu kundërvënë mosdijes mbi njohjen e fundit. Në esencë fundi mund të jetë i çuditshëm për njeriun sepse njeriu ka qenë i prirë vetëm drejt lartësisë, prandaj fundi i duket absurd.**

**Flamur Maloku**

**N**ë veprën poetike të Basri Çabriqit “Zbutja e gjarprit” çdo shenjë tokësore, gjatë leximit perceptohet si shenjë personale, çdo herë e artikuluar përmes një filozofie jetësore.

Andaj leximi i shenjave tekstore përbrenda strukturës së poezive, krijon një sistem figurash, që në esencë forcojnë idenë autoriale, dy janë figura të idesë personale; simboli dhe metafora, prandaj metafora dhe simboli, do të shënjojnë një mori idesh – kuptimesh, duke i bërë kështu poezitë me meditative. Mirëpo, duhet mos harruar se leximi i shenjave të jep mundësi që ta njohësh jetën në përgjithësi dhe thelbin e saj në veçanti. Sepse tema e jetës do të shtrihet gjatë tërë strukturës së veprës, duke u përcjellë vazhdimisht përmes situatave të dhimbshme tragjike, që vetë jeta na afron. Shenjat bëhen ide autoriale të vetë jetës. Trazimet shpirtërore thuren nga e vërteta jetësore, ku dilemat personale janë të pashmangshme. Dilemat personale vijnë si rezultat i vetë jetës, gjë që e bën subjektin të meditojë më shumë në lidhje me jetën dhe filozofinë e saj.

Kështu simbolika e shtresës tekstore krijon një polisemi shumëkuptimore, siç është poezia “Pasqyra”, ku teksti është një simbolikë e botës së njeriut. Njeriu nganjëherë nuk e mendon fundin, dhe vepron në mënyrë të pavetëdijshme, ku fundi në mendjen e tij nuk pranohet si diçka reale. Mirëpo, kur njeriu e pranon, atëherë tragjikja shpirtërore është e madhe. Kjo ndodh për arsye se fundin se ka paramenduar asnjëherë;

Se si zhvendosemi të gjithë në fund  
Në fund të fundit  
Çuditërisht në fund  
(Pasqyrë)

Autori përmes simbolikës, para së gjithash jep mesazhin e zgjimit të vetëdijes, çdo herë duke iu kundërvënë mosdijes mbi njohjen e fundit.

Në esencë fundi mund të jetë i çuditshëm për njeriun sepse njeriu ka qenë i prirë vetëm drejt lartësisë, prandaj fundi i duket absurd.

Shenja tokësore të mëtejshme thurin asociacione të shumta, ku me mjaft sukses autori bën gërshetimin e llojeve-temave-motiveve.

Njohja e vërtetë e jetës kërkohet nga subjekti si diçka e domosdoshme, ku vetëm përmes njohjes së saj perceptohet më mirë edhe realiteti ekzistues i botës.

Mirëpo në vazhdim të tekstit natyrisht akti i identifikimit, do të jepet përmes një gjendje emocionale. Akti i identifikimit vërehet përmes leximit të shenjave, që konotojnë gjatë procesit aktin e njohjes, dhe të vetë njohjes, që dalin si dy gjëra të mëdha, dhe të mundimshme. Mirëpo njohja dhe vetënjohja kërkon lirinë e vetëveprimit jo mbylljen-izolimim e njeriut, pa liri nuk ka njohje të botës, as vetënjohje të unit personal.

Është kjo çështje, ajo që do të shtjellohet në poezinë “Guaca” e cila si figurë brenda vetes nënkupton mbylljen e individit përbrenda një ambienti krejtësisht të pakuptimtë.

Andaj kërkohet liria individuale, në çdo pikëpamje, sepse mbyllja s’krijon gjë tjetër veç vdekjen e pakuptimtë.

Guaca, bëhet figurë metaforike-simbolike e botëkuptimore e tekstit, e cila do të identifikojë një ambient konkret, ambient i cili në idenë autoriale bëhet i neveritshëm-monoton, dhe të cilin subjekti nuk e dëshiron.

Autori në shtresën e tekstit avancojnë një botëkuptim filozofik, të prirë nga theksimi i lirisë individuale;

Hapu se  
Dua të dal  
T’pi ujë drejt nga qielli  
(Guaca)

Në esencë shenjat tokësore janë të hapura-shumështrësore dhe prirë kah e ashtuquajtura polisemi kuptimore.

Qielli në tekst paraqet si figurë hapësirë e pakufishme - Lirinë e pakufizuar andaj kuptimi dhe domethënia e tij është një specifikë e veçantë për njeriun.

Njohja dhe përgjithësimi i figuracionit si: qielli, deti, uji, krijojnë metaforën e perceptimit gnoseologjik të vetë jetës, duke u parë edhe në planin semantik. Figurat janë vazhdimësi e procesit të thellë, që i përshtaten konceptcionit së vetë tekstit dhe strukturës së tij.

Sa kohë u bë që jam mbyllur  
Humbur brenda o Zot  
E s’dëgjojmë zërat e ujit

Izolimi individual bëhet tragjedi autoriale, por me porosi universale. Zoti paraqitet i vetmi shpëtimtar, nga ku subjekti ka drejtuar sytë. Kështu, përmes një sistemi idesh, subjekti evokon situatë emocionale, por në përmasa dramatike. Gjithashtu

edhe poezia “Humnera”, ndërtohet me një gjendje tejet tragjike, ku shenjat e tekstit tregojnë një zbehje të raportit subjekt - objekt.

Se si ranë këto gjethe sivjet  
Krejt mënjane.  
(Humnera)

Shenjat bëhen theksim i një dimensionit emocional, para së gjithash theksim i gjendjes shpirtërore. Kontrasti shpirtëror - autorial lidhet me situatën reale, situatë e cila përcillet me një ftohtësi të raportit subjekt - objekt. Raporti është bërë i zbehur, për shkak të pakujdesisë. Autori do t’i përmbahet substratit metaforik ku sintagma (mënjane) bëhet shenjë e dëshpërimit. Andaj, qenësia e problemit qëndron pikërisht te mosnjohja e realitetit, ku kokat rrinë çdo herë mënjane.

Dhe koka ime mbetet andej  
Si mënjane.

Varësisht nga kjo autori nuk jep shpjegim pse tani kokat rrinë mënjane, mirëpo në idenë e lexuesit kuptohet. Shenjat bartin në vete problemin, përmes së cilava subjekti koncepton dëshprimin po edhe tjetërsimin individual.

Marrë në përgjithësi teksti i Basi Çabriqit shtron disa ide shumëkuptimore, siç thotë R. Barkthesi “Gjuha poetike e përqendruar në figurë fiton funksionin tjetër semantik”. Prandaj Basri Çabriqi përmes një ligjërimi tejet figurativ krijon në shtresën e poezive në përgjithësi një tematikë shumëkuptimore, ku çdo shenjë reflekton një mori idesh, të konceptuara nga vetë autori.

E gjithë kjo, kuptohet e nënkuptohet përmes figuracionit poetik, ku tërësia kuptimore e poezive do të bazohet tek përvoja personale, përvojë e cila bëhet shenjë e brendësisë autoriale. Krijimi i rrethanave subjektive paraqiten në tekst si realitet ekzistues. Çdo poezi shkrin brenda vetes idenë e njohjes dhe të rinjohjes subjektive, duke mos lënë anash gjykimin e botës së brendshme të njeriut, çështje kjo që bëhet brengë edhe e vetë autorit, sepse nga problemet e shumta që ka jeta është mënyra se si të jetohej kur ambienti dhe rrethi ku jeton e refuzon kodin e dijes dhe pranon kodin e mosdijes. Të gjitha këto probleme, Basri Çabriqi në veprën “Zbutja e gjarprit”, i shtjellon përmes ligjërimin tejet simbolik-metaforik-alegorik. Kështu që sistemi figurativ bëhet shprehje dhe botëkuptim i idesë autoriale.

Debat për letërsinë

# Një dokumentar fiksional

Rexhep Qosja, "Një dashuri dhe shtatë faje" roman

**"Një dashuri dhe shtatë faje" është dokumentar fiksional edhe për faktin se dokumenton aktualitetin e botës fenomenale, edhe pse më shumë të asaj sensitive/racionale; satirizon kontekstin; konstaton praninë e groteskes në kontekst; dëshmon praninë e ankthit permanent të personi i atij konteksti. Këtu shkaktohet edhe përplasja e konteksteve, ku konteksti brenda-letrar satirizon në mënyrë implicite kontekstin jashtë-letrar.**

Ag Apolloni

Iluzioni / aluzioni

**V**epura "Një dashuri dhe shtatë faje" e Rexhep Qosjes është roman që krijon iluzionin e dokumentarizimit narrativ të udhëhequr nga narratori subjektiv. Këtë iluzion e përforcon edhe më shumë kërkesa për leximin e tekstit si dorëshkrim i gjetur nga "botuesi", fjala hyrëse e të cilit shënjon kontekstin e "dorëshkrimit". Kështu, që në fillim, shfaqet nevoja për lexim të trefishtë të romanit; jemi të detyruar të lexojmë paralelisht Rexhep Qosjen, Çerem Çaparin dhe Arben Begajën. Dallimi qëndron këtu: romani i autorit real përfshin tekstin fund e krye, pra tërë tekstin që gjendet brenda dy kopertinave, ndërkaq romani i autorit fiktiv (Çapari) nis pas paratekstit "Fjalë paraprake, e gjatë" dhe mbyllet para tekstit të "botuesit" mbi kontekstin e tij dhe të autorit fiktiv, "Dosja kuqezi". Krejt çka mbetet, i përket "botuesit" të dorëshkrimit. Leximi i trefishtë ngrihet mbi vetëdijen artistike për diferencimin e domosdoshëm të autorit nga narratori apo narratorët. Qosja, ashtu si edhe Kafka të "Procesi", në këtë roman kontestohet nga narratori, veçse, përderisa të Kafka kontestimi është implicit, këtu ai është i hapur, madje narratori, që është edhe autor fiktiv i librit, shfaqet si një lexues i autorit real.

Nevoja për leximin e "dorëshkrimit" si dokumentar, krijon iluzionin e imitimit besnik të realitetit objektiv, por, sapo lexuesi nis vrojtimin e përngjasimit të veprës me realitetin objektiv, zhgënjehet dhe kujton ballinën e librit, ku, aty nën titull, ka parë përcaktuesin kategorial: roman. Lexuesi tani kupton trukun: romani është dokumentar fiksional, pra fiksion literar i realitetit subjektiv apo realitetit shpirtëror.

Kështu, nga ky prizëm duhet parë edhe


kërkesën narritoriale për lexim "të ftohtë", dokumentaresk. Shkrimi këtu na paraqitet si shkrim dëshmues dhe konstatues, sepse iluzioni i shkrimit si imitim, i prin aluzionit të tekstit në lexim.

Natyrisht, sfida e argumentimit nuk përfundon me kaq. Romani "Një dashuri dhe shtatë faje" është dokumentar fiksional edhe për faktin se dokumenton aktualitetin e botës fenomenale, edhe pse më shumë të asaj sensitive/raciona-

le; satirizon kontekstin; konstaton praninë e groteskes në kontekst; dëshmon praninë e ankthit permanent të personi i atij konteksti. Këtu shkaktohet edhe përplasja e konteksteve, ku konteksti brenda-letrar satirizon në mënyrë implicite kontekstin jashtë-letrar.

**Intertekstualiteti / postmoderniteti**

"Një dashuri dhe shtatë faje" është roman i botuar në mileniumin e tretë, përkatësisht në vitin 2003, kur intertek-



stualiteti si teori postmoderniste është në qendër të interesimit. Ai ngërthen brenda vetes kulturën e kultivuar të shkrimit dhe leximit postmodern, madje dëshmon për një traditë të postmodernizmit në prozën e Qosjes, në fakt, vetëm në dy romanet e tij.

Intertekstualiteti si teori dhe postmoderniteti si sensibilitet dhe konceptim epokal janë aplikuar në këtë prozë të sofistikuar, ku shkrimi si proces aktual ka për objekt situatat aktuale të kontekstit të para nga optika personale. Madje, potencimi i aktualitetit si tipar tipik i postmodernizmit (J. Habermas), herë-herë është arsyeja e ndërfitjes së citatësive brenda këtij romani aktual të aktualitetit, i cili dialogon me tekste nga Montesque, Goethe, Sabato, Joyce, Fishta, Bibla, Kur'ani, letërsia orale etj. Parimi i intertekstualitetit e përshkon gjithandej romanin "Një dashuri dhe shtatë faje", si në ide dhe tema, ashtu edhe në diskurs. Autori dialogon me traditën letrare, pikërisht me klasiken, dhe e përvetëson atë sipas nevojave të tekstit të tij. Copëza tekstesh nga autorë të ndryshëm, e sidomos nga Montesque, bëhen pjesë përbërëse dhe funksionale të tekstit të Qosjes. Kështu që, teksti i tij na vjen si një palimpsest postmodern, domethënë si një vepër që nuk e fsheh ndikimin. Përkundrazi, e potencon atë me vetëdijen mbi pamundësinë e ekzistencës së "tekstit të virgjër" (R. Barthes) dhe me synim të afirmimit të tekstit të vjetër.

Natyrisht, përfillja e parimit intertekstual nuk është i vetmi element që e bën këtë roman të jetë postmodern. Porse, ndërfitja e teksteve të vjetra në tekstin e ri, është parim i postmodernitetit letrar, i cili afirmon veprën e re si muze i ri me relike brenda. Këtu tekste dialogojnë me njëri-tjetrin dhe kryejnë funksionin e argumentimit të çështjes, përkatësisht plotësojnë njëri-tjetrin në aspektin semantik. Edhe arsyeja e pranisë së rrëfimit (narracionit) si pjesë me përqindje më të madhe në këtë roman, është çështje parimi në tekste postmoderne, ku rrëfimi gjithmonë është në qendër të vëmendjes (L. Hutcheon), ai nënkupton kohën, për dallim nga përshkrimi që lidhet direkt me hapësirën.

Ndër parimet e poetikës postmoderne është edhe pozicionimi kritik ndaj së kaluarës dhe konstatimi i aktualitetit, i cili brenda sekondës bie në prehrin e historisë. Permanenca e historizimit të aktualitetit na shpie nga njohja e dy tipave të aktualitetit: aktualiteti i mbyllur dhe aktualiteti i hapur. I pari i referohet të tashmes historike (se edhe ajo që sot është e shkuar, dikur ka qenë

e tashme, pra aktualitet), ndërkaq e dyta i referohet të tashmes aktive, permanente (asaj që ende s'e njeh pasivitetin, mbylljen).

Këta dy tipa të aktualitetit, shfaqin bindjen e postmodernistit se pasojat e së kaluarës në të tashmen, kanë shkakun e tyre në mungesën e përgjegjesisë dhe të shkathtësisë së veprimeve humane në aktualitetin historik. Së këndejmi, njohja dhe përgjegjësia për veprim aktual modern (të hapur), nënkupton vetëdije të plotë mbi ekzistencën dhe rrënon idealizimin e ardhmërisë së lumtur në mungesë të veprimit të mbarë në të tashmen. Sepse, njeriu nuk mund të jetojë as në të shkuarën e as në të ardhmen, ai merr frymë në të tashmen permanente. Theksi mbi të tashmen është vendosur edhe në "Një dashuri dhe shtatë faje", që është roman i revoltës, ngaqë revoltohet ndaj gjumit (të Mexhid Tojës), i cili figurativisht shenjon mungesën e të menduarit dhe të të vepruarit.

### Struktura / idetë

"Një dashuri dhe shtatë faje" është libër bi-statusor (me status të dyfishtë). Mund të lexohet edhe si roman, po edhe si libër me tregime. Pra ka status alternativ për lexim. Përfshin gjithsej nëntë tregime, prej të cilëve tetë janë të Çaparit, kurse i nënti, bashkë me "Fjalën hyrëse..." dhe me "Fjalën përmbyllëse...", janë shkruar nga "botuesi" i "dorëshkrimit". Gjithashtu, edhe dhjetë tekste të titulluara "Nga fletorja e shënimeve", që shërbejnë si argument për secilin tregim vijues, janë të Çaparit.

Secili tregim i kësaj vepre ka situatën dhe figurën specifike. Tregimi i parë "Profeti më kishte thënë" ka figurën e vet, profetin Mihran Kumanin, i cili flet më fjalë të rrumbullakëta, me zë të mezidëgjueshëm dhe nuk përmend kurrë emra të përveçëm, pos atyre të profetëve dhe të Zotit. Tregimi tjetër "Ethe dje dhe ethe sot", në të cilin përballen ethet e shumicës me gjumin e profesorit, përshkohet nga satira alegorike, madje shkohet deri në groteskë (Kush Akxhiu me dy flamuj në dorë, hip në kulm për t'i shpëtuar vërshimës, ndërsa Mexhid Toja, që fle kur të tjerët dridhen nga ethet, një ditë zgjohet nga gjumi-i vdekur!). "Dita kur kishte humbur kujtesën" është tregimi i radhës, në të cilin bëhet objekt gjenialiteti i Man Kurtit, i cili do të pësojë amnezi dhe do të humb identitetin personal, nga Man Kurti do të bëhet man kurti, domethënë nga i përveçëm do të bëhet emër i përgjithshëm, nga Subjekt do të bëhet

objekt, nga qenie për vetvete do të bëhet qenie në vetvete.

"Fjalori i fshehur" është tregim mbi tjetërsimin e kuptimit të fjalëve, është zhveshje e fjalëve nga kuptimi i parë dhe zbulim i ironisë së fshehur të tyre. P.sh. fjala brirë d.m.th. përkrenare që gruaja ia vë burrit. Ose, fjala çarshi-treg i thashethemeve.

Tregimi i pestë me radhë "Dita kur e kishte humbur zërin", në të cilin, pas përhapjes së etheve, historiani Rozaf Gashi nuk mund të flasë më, pasohet nga tregimi "Hana Ujëmiri", që emërtohet kështu në bazë të emrit të dashnores së Çaparit e cila "është personazh kryesor në jetën" e tij, por jo edhe në këtë roman.

Tregimi i parafundit i "dorëshkrimit" quhet "Vdekja e dyfishtë" dhe flet për vdekjen e Kush Akxhiut, i cili përcillet deri të Varret si atdhetar, por varroset si tradhtar. Pas këtij, vjen tregimi "Kolona e pestë e shejtanit". Këtu në plan të parë dalin qentë, prandaj pakohen njerëzit. Qentë këtu simbolizojnë nuhatjen dhe kafshimet e pushtetit, pra sigurimin e pushtetit diktatorial.

Vetë titulli "Një dashuri dhe shtatë faje" shfaq disproporcionalitetin e veprimeve të autorit fiktiv (Çapari), që është edhe narrator edhe personazh. Dashuria dhe tre fajet (i pari, i dyti dhe i shtati) në këtë rast, janë veprime të pavarura të njeriut (Çaparit), sepse asnjëra nuk vjen nga vetëdija e dashuruesit apo fajtorit. Si dashuria, ashtu edhe këto tre fajet, janë jashtë kontrollit racional të Çaparit. Ai dashuron jo për ndonjë arsye, sepse "zemra ka arsye që arsyeja s'i njeh", por pse kjo është e pashmangshme, natyrisht edhe e pakuptimshme racionalisht. Edhe ato tri "fajet" janë po ashtu të pashmangshme dhe absurde.

Mirëpo, t'i shohim radhazi të shtatë fajet për të cilat Çerem Çapari shpallet fajtor: 1. ka emrin Çerem; 2. është nip i Xhezairit të Gjikës; 3. ka shkruar prozën e tij alegorike "Vampiri"; 4. ka vizituar dhe ka nderuar viktimat në morg; 5. ka refuzuar diferencimin politik; 6. ka përkrahur parullën e popullit të vet; 7. ka pasur flirt me Hana Ujëmirin, femrën që vishej kuqezi.

Por, faji i vërtetë i Çerem Çaparit ishte, si thoshte "botuesi" i tij, "pse donte të ishte person e jo personazh". Dhe, pikërisht kjo dëshirë për të qenë person, ka shërbyer si motiv për shkrimin e fiction-it si faction, duke imponuar kështu përkufizimin statusor nëpërmjet oksimoronit "dokumentar fiksional".

Poezi

# Bardh e zi

## Zot

Frymë e jotja më mbulon  
Në çdo cep të plagës sime  
Si një fije pranverore  
Që lulëzon në horizont  
Dritë e jotja më krijoj  
Ndër ujëvara të trazuara  
Zot kërkoj strehë  
Në fosilet e bardha

Në kristalet e ngrira  
Në dorën tënde

Mbyllet sinjali i ndezur  
Unë krahë pulëbardhe  
...frymë njeriu  
Tek ju gjej shpëtimin.

## E Diel

Ora 12  
Mollët e kuqe po bien  
Në këtë çast  
Zjarret po fiken  
Nga pika shiu  
Buzët po puthen nën çati  
Dashuria e parë  
Po tingëllon në telefon  
Sikur po dremit ujëvara  
Në dritare dielli po ngrohet  
Në prapaskenë  
Prap tik-taku  
Me zilen magjike  
Puthi numrin 12.

## Nënës

Ajo zgjohet e plakur në shpirt  
E vrarë në zemër e shikime  
Me duar mbi sy duke prekur lotin  
Ajo flet më vëllain e madh e të voglin  
Ua prek ballin e i fton në ëndërr  
Ata këmbëkryq në mur  
Në heshtje i buzëqeshin  
Dua të ju shoh prek e puth  
Ashtu si dikur që piqeshin qershitë  
Nata erdhi me velin e mpirë  
Por dëshira e nënës ngeli pengë i bardhë  
E bardhë është vdekja kur ajo të pret  
Se zëri i tyre tani më thërret  
Jeta po vazhdon  
Sikur rrëfimet për jetën  
Malli e gërryen nënën  
Sikur malli gurin.

## Bardhë e zi

Loz me borën e ujis dorën  
Në stinë puthet buzëqeshja  
Më shqisë të nuhas ty  
Lakuriqe si bora  
Borë e parë shpalos kujtimin  
I mbyll qepallat në kuvertë  
E tëra skuqet nga buzët e saj  
Në mesnatë kur bora shkrin  
Rrezet e kristalta thyhen  
Që priten në lartësi  
Dhe prapë nis shiu  
Më agun e parë  
Pa humbur shikimin  
Që ndezët si zjarr  
...Nis borë përsëri  
E fiket në tokën e mërdhirë  
Në heshtje rinis shfaqja  
E fillon përsëri  
Gjithçka bëhet  
Bardhë e zi...

## Balit monument

Flokun ia shprish krisma  
E mbi vetull i bie  
Nën vallen e vdekjes  
Këndon për liri

Buzëqeshje e ëmbël  
I ka rënë në buzë  
Jehona e zëri  
Nuk do t'i vdesë kurrë

As shiu që bie  
As vala që rrëmben  
Nuk do ja qëmtojnë lirinë  
Fazliut të vogël që po vjen  
As Balit Monument...

## POST MORTUM

Dritëz e mëngjesit zbardhi  
E rrezja ftohej ngadalë  
Shpejt qielli u bë gri  
Moti krisi si dikur moti...  
Ora e stuhisë pikohej  
Ra trumbeta...  
I njom buzët jetë-vdekjes  
Terri e mbuloi në fytyrë

Maji i lulëkuqeve  
U tret përsëri  
Humbi buzagazi  
As frymë e heshtur  
Më nuk flet  
E klithma ikën tok  
Tehut të vdekjes

Jeta iu bë varr  
Atdheu libër nën sqetull  
Këngë funebre kumtoi  
U fikë gëzimi fëmijëror  
Por rilindi në poezi  
I vogël madhështor te lapidari  
Trimoshi pavdekësinë jeton.



Tregim

# TE GURRA E SHQIPONJAVE

Valmira PEÇI

**P**o përtpynin shpejt e shpejt atë pak bukë që u kishte mbetur. Dielli përvëlonte me nxehtësi lufte. Pranvera shpërndante gjelbërimin me ngadalësinë e breshkës.

Aty-këtu ndonjëri mundahej ta thyente heshtjen, edhe pse në kohëra të tilla kobi i heshtjes mbizotëron.

- Ëndrra të këqija pashë sonte. Pashë ëndërr sikur po marthonim Xhevdetin. Ç'dasmë të madhe bënim! Vargu i krushqve i gjatë sa rruga që kemi përpara, unë isha bajraktar...Përnjëherë se si u ngrimë të gjithë, veç flamuri ende valonte njësoj... – e theu heshtjen baca Milazim.

- Herët më paskëshit martuar bacë, jam i ri për martesë, por jo për luftë. Kam punë të tjera unë, ta përzëmë armikun njëherë eh... – ia ktheu Xhevdeti.

- Eh, dasmë e madhe po na pret! – pëshpëriti Nazmiu.

- Jeni të rinj, djemtë e mi, ç'të bëj me ju të rinjtë se sa për vete ..., ja që guximi nuk njeh moshë bacë – arsyetoi ai.

- Si flet ashtu bacë, ne jemi betuar dhe

kemi vendosur të qëndrojmë këtu dhe do të qëndrojmë derisa të qëndrojë Guri i Madh dhe derisa të ketë ujë Përroi – fliste Vetoni syapatrembur.

- Kokëfortë jeni ju, kokëfortë – miratoi mixha Shahin.

Shkëlqimi, Fadili, Vetoni dhe Xhevdeti filluan të qeshin. Fytyra u qeshte e sytë u vezullonin në dritën e lirisë. Kurrë më të bukur nuk kishin qenë.

Mjegull e dendur zbriste nga Kutllovci, tym i zi dilte nga Tërstena. Vranësirat përnjëherë morën qiellin.

- Hapat e vrazhdë të vdekjes po fërkohen drejt nesh – plotësoi Aliu, edhe pse çdo gjë dukej e qartë.

- Çizmet e përgjakura po rropaten teposhtë Dollovës por kockat do t'i lënë te Shpella – u dha forcë shokëve Elmazi.

Dita po perëndonte. Mixha Shahin i kishte vendosur dorën mbi sup të birit dhe po e tërhiqte afër vetes sikur donte ta mbulonte me trupin e tij, kurse me grushtin tjetër ledhatonte dorën e njomë të Fadilit.

- Jam rritur vetë jetim, bile këta le ta njohin dashurinë prindërore. Zot, që m'i fale dy, mos m'i ndaj tani – lutej në

heshtje.

Rrethi gjithnjë e më tepër po ngush-tohej në kurth të hekurt çetnik. Baca Milazim shikonte mixhën Shahin, ky i fundit shikonte Aliun, Aliu i bëri me shenjë Elmazit. Shikime të kryqëzuara që flasin shumë.

Elmazi po shtrëngonte fortë bombën në dorë. Vrulli i zemrës i sillte vërdallë nënën, gruan, vajzat. Në vend të tyre pikaste Vetonin.

- Po ti, ç'deshe këtu? Nuk mund ta pres vdekjen tënde – tha për herë të fundit. Rropatja u shndërrua në kroatatje sor-rash.

- Përpara pëllumba, t'i dalim tankut me gjoks e plumbat t'i presim me dorë – porositi Aliu si i ati dikur.

Nga maratona e ferrit e tmerrit edhe Guri i Madh u thye. Ata jo. Se njeriu më i fortë se guri. Dielli shkoi prapa Kodrës së Kutllovcit për të rilindur, përroi shteroi për të rirrijedhur, luleve u humbi aroma për t'u rinuhatur me aromën e lirisë.

Te Gurra e Vrellës rrodhi gjaku, mori përroskat dhe u shtri në tërë lumenjtë e Kosovës. Nëntë shqiponja fluturuan drejt qiellit në pavdekësi.



## Leximi i tekstit

# IMAZHI I JETËS SHPJEGOHET PËRMES DHEMBJES

Poezia e Ali Podrimes 'Lum Lumi' shenjon fatin e individit përballë situatës së re jetësore, dhembje e cila i bëhet e njohur kolektivit si tejkalim i mundshëm.

Fitim VELIU

**P**oezia e Ali Podrimes 'Lum Lumi' në nivelin tematik, mund të zbërthehet përmes dy apo më shumë metodave, duke pas parasysh se struktura e tekstit të veprës mund të jetë tejet komplekse. Që në fillim vetë titulli i përmbledhjes së poezive Lum Lumi, mund të interpretohet në nivele të ndryshme tematike. Lum Lumi si tekst poetik ka kuptimin e një lumi që rrjedh, por gjithashtu Lum Lumi ka kuptimin e gëzimit për diçka që është shumë e dashur për njeriun, e që në këtë rast del poeti i cili mundohet ta tejkalojë dhembjen përmes vargjeve poetike. Lum Lumi në këtë rast inkorporon forcën e një linje ndërmjet dhembjes, kujtimit dhe ëndërrimit. Poezia e Ali Podrimes 'Lum Lumi' shenjon fatin e individit përballë situatës së re jetësore, dhembje e cila i bëhet e njohur kolektivit si tejkalim i mundshëm. Lum Lumi është një shpërthim i ndjenjave të cilat artikulohehen përmes figurave: metaforë, simbol, antitezë. Tani do të ndalemi te më tipikja e kësaj skeme, ku poeti shpreh dhimbjen përmes kërkimit të shenjës apo krahasimit me figurën e mbretit Dioklecianus, i cili sun-

doi një kohë si mbret. Vjersha 'Mbreti im i vogël Dioklecianus', ku poeti artikulon dhembjen për mbretin (djalin) e tij të vogël, shpie te paragjykimi që është mosnjohje, sepse nuk ceket se cili mbret i vogël apo i madh. Nuk mund ta dimë se sa është në dijeni poeti për historinë e këtij mbreti, që në këtë rast simbolizon djalnë e vogël të poetit. Ky mbret nuk mund të shquhet për asgjë të mirë, pasi ai ishte një mizor, i cili njihet vetëm për torturat e tij në kohën kur njerëzit po fillonin të besonin në një ZOT. T'i cekim disa vargje sa për ilustrim:

Kur të zgjoj

Thellë në lashtësi nxjerr zë  
Guri im peshë fiton hapësirë  
Mbreti im i vdekur Dioklecian

Për poetin zgjimi i dhembjes për të bërë përjetohet si dhembje që lidh kohën aktuale me kohën e shkuar të mbretit. Këtu shqiptohet imazhi i jetës, që shpjegohet përmes dhembjes. Në vjershën tjetër Dumvenio, shpërthen metafora e dhembjes njerëzore, pra vdekja e djalit:

Ti i vdekur zaten ishe

Përgjithmonë tash të shoh të vdekur  
Malli, dhembja dhe në fund shpërthimi  
i tyre tregojnë pesimizmin  
e autorit për takimin

e mundshëm me djalnë e tij, i cili në logjikën e autorit nuk kuptohet si një transformim apo shndërrim në një jetë tjetër. Qetësimi i shpirtit të autorit arrihet vetëm përmes dialogut ëndërrimtar, ndoshta një pesimizëm i autorit vërehet edhe në poezitë e tjera: në poezinë 'Kërkon atë që nuk mund ta gjej', pra nga malli dhe dhimbja nuk i gjen përgjigje pozitive shpresës së takimit me djalnë e tij ku thotë:

kërkon diçka që moti e kam humbur,  
por prapë vargu inicial

Ti kërkon diçka që kurrë nuk mund ta gjej,

pra autori nuk e mbyll vargun si pamundësi të gjetjes së asaj që del e humbur. Autori lejon kërkimin e asaj që i duket e humbur. Dhembja e poetit për Lumin në disa poezi del si pesimizëm si p.sh: Dhembja Ime, Në dhomën e vdekjes, Je e nuk je. Në poezinë 'Në dhomën e vdekjes', shënohet tragjiciteti shpirtëror i autorit. Poetit i duket gjendja e birit të tij si tejet e rëndë, pasi ai e krahason dhimbjen e tij me ato të Gjergj Elez Alisë, por tani autori ndodhet përballë një situatë që nuk ka fuqi që të ndryshojë diçka në të mirë të Lumit, por sikur forcohet besimi i tij, se kjo çështje i takon vetëm Zotit. E themi këtë, sepse në vjershën 'Je e nuk je' thotë:

sillem rreth flakës sate, nuk mund të shpëtoj o Zoti im.

Poezitë në vazhdim si: 'Dhembja ime', 'Në dhomën e vdekjes', 'Parisi vendlindja', 'Nën dritare digjej Parisi', janë poezi të cilat artikulojnë jetëshkrimin e autorit në kohë dhe hapësirë për të kërkuar sublimen. Poeti përmes shpalosjes së dhembjes individuale, duke ia bërë atë të njohur kolektivit, arrin ta shuajë tragjicitetin e dhembjes shpirtërore. Në vjershën: 'Nuk kam bërë asgjë për Lumin', ku riaktualizohet dhembja e tij si takim imagjativ me Lumin, në fakt ajo që precizon autori në vjershë është koha e kaluar që nuk kthehet dot, por nga kjo ai dëshiron të shfajësohet para kolektivit.

E gjithë përmbledhja shenjon mallin, dhembjen për Lumin. Kjo përmbledhje poetike është jetëshkrim i autorit, në të cilin projektohet dhembja si tejkalim në zbërthimin e reales dhe projektimin e imagjinatës, pra është tejkalim i dhembjes duke e mbajtur gjallë kujtimin për Lumin.



**Bisedë me Ferki Shalën**

# Adaptimi im kaloj shumë lehtë dhe me shumë kënaqësi

**P**AQJA: Publiku i Kosovës ju njeh si këngëtar të madh me shumë këngë

hite, të cilat i pëlqen edhe sot. Ku është tani Ferki Shala?

**Ferki Shala:** Tani është në relacion banesa-xhamia-lokali (ushqimor) po sa i hapur.

**PAQJA:** Çka ju shtyri ta ndërpreni muzikën?

**Ferki Shala:** Frika nga e kaluara dhe dëshira te pendohem tek Allahu xh.sh.

**PAQJA:** Sa ka qenë vështirë për ju të adaptoheni me një mënyrë tjetër të jetës?

**Ferki Shala:** Deshti All-llahu xh.sh. dhe adaptimi im kaloj shumë lehtë dhe me shumë kënaqësi.

**PAQJA:** Si e kane pritur familja, njerëzit tuaj, vendimin për të lënë muzikën dhe ti përkushtoheni fesë?

**Ferki Shala:** Familja dhe të afërmit e mi me shume kënaqësi dhe respekt, por jo edhe "shoqëria". Disa prej atyre me një rezerve dhe dëshirë që të kthehem sa me shpejte jetës së përparshme.

**PAQJA:** Videoklipet e këngëve tuaja emitohen ende në TV, si ndiheni kur i shikoni?

**Ferki Shala:** Nuk kam kohë për ta përcjell TV, thjesht, është e kaluara për mua.

**PAQJA:** Si nis një dite për ju dhe si mbaron ajo.

**Ferki Shala:** Normal, nisët sikur edhe te të tjerët mysliman besimtar, me marrjen e abdesit për të falur sabahun, andaj punë - namaz - punë ... dhe mbaron me namazin e jacisë.

**PAQJA:** Ku e gjeni frymëzimin?

**Ferki Shala:** Elhamduli-llah në namaz dhe besim.

**PAQJA:** Këndoni këngë fetare - a ka qenë vështirë të adaptoheni te përshtatani?

**Ferki Shala:** Jo, nuk ka qenë vështirë, sepse talentin cilin ma ka dhënë All-llahu, vetëm e kam përshtatur

dhe transferuar në Ilahi është shumë ma lehtë por përgjegjësia është më e madhe.

**PAQJA:** Jeni duke përgatitur albumin me Ilahi?

**Ferki Shala:** Po, një projekt me 8-9 Ilahi dhe insha All-llah në pranverë kam plan të bëjë edhe një apo dy spote, varet prej sponsorëve. Janë të mirëseardhur.

**PAQJA:** Çka pret në këtë vit në rrafshin politik?

**Ferki Shala:** Pos zgjedhjes së statusit final ( kuptohet PAVARËSIA ) e lus All-llahun xh.sh. të


na mundësoj që sa më shpejtë të nisemi me ndërtimin e xhamisë buzë Ibrit në veri te qytetit, Insha-All-llah.

**PAQJA:** Çka ju bezdis në jetë më shumë?

**Ferki Shala:** Gënjeshttrat dhe premtimet e kota.

**PAQJA:** Porosia juaj për lexuesit.

**Ferki Shala:** Së pari juve ju uroj sukses në këtë punë, All-llahu ju lehtësoftë, e lexuesve tanë dëshiroj çaste të këndshme me Paqen dhe t'na mëshiron All-llahu neve dhe Kosovën tone së bashku.



# Lajme nga teknologjia

## Shkelzen NUZA

### Sony Handycam DCR-SR82 60GB HDD Camcorder

Sony ka nxjerrë në treg një kamerë Handycam DCR-SR82 camcorder me 60GB hard disk drive. Sony DCR-SR82 ka sensor 1 Megapixel CCD, Carl Zeiss Vario-Tessar Lens me 25X Optical zoom dhe 2000X Digital Zoom. Gjithashtu ka edhe një 2.7-inch Wide Touch Panel Hybrid.



### Panasonic DMP-BD10 Blu-ray player

Panasonic DMP-BD10 mbështet Blu-ray disc playback, vjen edhe me EZ-Sync HDAVI që u lejon shfrytëzuesve të çasen në pajisjet tjera me lehtësi. Gjithashtu përkrah DVD dhe CD. Ky mbështet edhe dubli digjitale me 5.1-channel Dolby Digital dhe DTS soundtracks dhe ka dalje për HDMI output. do të jenë në treg në pranverë të këtij viti.



### Fletat që fshihen vet pass 24 orësh

Sa e sa dokumente i shtypni për një periudhë të shkurtë? Juve ju nevojitet agenda e takimeve, web faqja. Ju e përdorni atë një here ose dy dhe ajo pastaj gjuhet në shportë apo edhe shkatërrohet krejt. Xerox ka bërë një hulumtim për këtë duke analizuar se si njerëzit e përdorin letrën dhe kjo kompani ka konstatuar se 2 prej 5 faeve që shtypen janë për përdorim të përkohshëm. Për këtë ka zhvilluar edhe një letër të tillë.

### LG CYON SB190 Phone me GPS dhe DMB

LG sjell në treg SB190 e tij, një telefon të pajisur me GPS dhe DMB. Telefoni ka kamerë 1.3 Megapixel si dhe MP3 player të integruar. Gjithashtu ka edhe DMB digital TV tuner dhe Mobile XD engine të cilat ofrojnë kualitet të lartë për video playback. LG SB190 vjen edhe me metro hartën e Seoul dhe gjithashtu mund të përdoret edhe si USB.



### Fjalor elektronik me MP3 Player nga Canon

Canon ofron dy fjalor të ri elektronik (the Wordbank M300 and V300) për studentët japonez. Ata janë të psjitur edhe me MP3 player (Mp3 fajlla në SD card). Këta fjalor bartin 38 volume të ndryshme, disa prej tyre me TTS (Text-To-Speech) për anglisht, në mënyrë që të siguroheni se shqiptimi juaj është korrekt.



### Panasonic SDR-S150

Është një camcorder perfekt për pushime, është shumë i lehtë sepse inçizon me një kartelë 2GB SD, ka tre CCDs, thjerrëzën me 10x zoom dhe stabilitet optik të fotografisë por ka problem me kualitetin e fotografisë.



### Sony KDS-55A2000

Kushton diku rreth £1,500, Sony's 55-inch KDS-55A2000 është një prej TV 'full HD' më të lirë në treg. Ky funksionon në mënyrë perfekte dhe çmimi i tij është sa gjysma e çmimit të të njëjtit të prodhuar nga LCD TV.



### Palm Treo 750v smartphone

Ky kombinon telefonin, emalin, mesazhet dhe Windows Mobile në një pajisje që e bën atë më të lehtë dhe më produktiv se kurrë më parë. Pranon shumë email-a njëkohësisht. Çaset në web prej cilitdo vend ku ndodhni duke shfrytëzuar rrjetën 3G. Përdorë aplikacionet e Microsoft Office Mobile për editimin e dokumenteve afariste kudo që të jeni. Gjithashtu, ju ofron mundësinë që të relaksoheni duke dëgjuar muzikë, video klipje, apo nëse dëshironi të dërgoni foto dikujt.




## PC Kartelat

Type II PC Kartelat përdoren që të ofrojnë hapësirë për ruajtje për laptop por më herët janë përdorë edhe si Hard Disqe.


CompactFlash, SmartMedia, Memory Stick, SD Memory Card dhe xD formatet e kartelave përdoren në kamerat digjitale dhe në një llojllojshmëri tjera pajisjesh.

RS-MMC dhe miniSD kartelat përdoren kryesisht në telefonat celular



## Sony lanson kamerën e parë digjitale Wireless

Sony lansoj kamerën e parë digjitale wireless që ka: point-and-shoot ultra-compact camera, gjashtë-megapixel Cyber-shot DSC-G1, i cili do të jetë në gjendje të përdorë infrastrukturën e lidhjes së rrjeteve 802.11b dhe g për dërgimin e fotove përmes rrjetës Wi-Fi .



Type II  
PC Card

# 10 krijesat që (ndoshta) nuk e keni ditur që janë helmuese

Dikush njëherë ka thënë: “Diçka që nuk e njih nuk mund të të lëndojë!” Ja, këtu kemi një argument kundër kësaj: “Është mirë ta dish nëse diçka është helmuese para se t’i afroshesh (apo para se të të afrohet!)”

Këtu kemi paraqitur (të pamaskuara) 10 krijesa që nuk ngjasojnë të jenë helmuese, në mënyrë që t’u japim një mundësi më të mirë në rast se do t’ia mësyni “mbretërisë së egër”.


**1. Pitohui i Mbuluar:** - Pitohui i Mbuluar (ang. Hooded pitohui; ) i Guninesë së Re, i emëruar edhe si “pitohui di-



chrous” (“zogu mbeturinë”, ose “Pachycephalidae”) është i vetmi rast apo shembull i dokumentuar i zogut helmues. Po, zog helmues!

Në vitin 1989 një hulumtues, John P. Dumbacher, nga Parku Zoologjik Kombëtar në Uashington, zbuloi që puplat dhe lëkura e Pitohuit të Mbuluar përmbajnë një neurotoxin të fuqishme të quajtur homobatrachotoxin, e cila shkakton shpim dhe mpirje të lëkurës së njerëzve që e prekin këtë zog.

**2. Peshku i Gurit:** - Peshku i Gurit me një madhësi mesatare prej 35-50 cm është i përhapur më shumë në Oqeanin Indian dhe Pacifik. Ai jeton në fund të ujërave dhe është i maskuar apo i kamufluar në formën e gurit, prej nga e ka



marrë edhe emrin.

I armatosur në anën dorsale me gjemba, të cilët lirojnë një toksinë (toxin) helmuese, ai është më i rrezikshmi nga peshqit helmues dhe toxina helmuese e tij mund të shkaktojë dhimbje të ndryshme: shok, paralizë dhe vdekje të indit, varësisht nga shkalla e depërtimit. Gjembat e mprehta dorsale përmbajnë mjaft helm sa për ta mbytur një njeri të rritur, i cili do të jetë mjaft fatkeq nëse shkel mbi të.

**3. Platypusi:** - Platypusi apo shputëgjëri është një mamal që lind me vezë,



është ujë-tokësor i mbuluar me një shtresë të dendur të gëzofit, dhe është autokton në Tanzani dhe në Australinë Jugore dhe Lindore. Me bisht dhe me sqep të rrafshët i përngjan një rose. Mashkulli i këtij lloji, jo femra, në këmbët e pasme ka disa nyje helmuese të mprehta, të cilat prodhojnë një koktej helmi të përbërë më shumë nga defensina, e cila është unike te platypusat. Edhe pse mjaft e fuqishme për t’i mbytur kafshët më të vogla, helmi i tij nuk është vdekjeprurës për njeriun, por shkakton dhimbje torturuese me intensitet aq të fort sa që viktimit mund ta dërgojë deri në paaftësi.

**4. Flutura e Natës Bisht-kafeje:** - E quajtur edhe si “caterpillar” Është brejtës i gjetheve. Bën pjesë në llojin fluturave të cilat janë aktive gjatë natës. Me pamjen e një krimbi të parrezikshëm, kjo “flutur” është e mbuluar me qime të bardha dhe të kafenjta. Prej kësaj

“fluturë” duhet pasur kujdes. Është me gjemba dhe përmban substancë



helmuese. Në kohën kur e ndërrojnë “veshjen” shpesh barten nga erërat. Kur ndeshen me njeriun, qimet e tyre mund të shkaktojnë probleme të frymëmarrjes dhe të irritojnë puçrra në lëkurë. Për ata që mund të jenë alergjik ndaj tyre, kjo mund të jetë shumë fatale. Le ta dimë se në vitin 1908, një vdekje ka qenë si pasojë e “bisht-kafejes”.

**5. Centipede:** - Centipede apo njëqind-këmbëshi edhe pse quhet kështu në fakt ka më pak këmbë, por mendohet se ekzistojnë të tillë edhe me 200 këmbë.



Sidoqoftë, një palë nga shumë këmbët e tij kanë nyje shumë të forta që përfundojnë me thonj apo kthetra të mprehta në të cilat hapet një gjëndër helmuese. Këto këmbë shërbejnë për ta pushtuar dhe për ta mbytur gjahun. Por, te disa disa lloje, kafshimi i tyre mund të jetë helmues për njerëzit, mirëpo jo vdekjeprurës për ata që nuk janë alergjikë (por mund të jenë vdekjeprurës për ata që janë alergjikë!!!).

**Përgatiti: Bujar SEJDIU**

## PROVERBA TË NDRYSHME


1. Nuk ka më keq se kur njeriu fillon të ketë frikë nga e vërteta. L. TOLSTOI
2. E vërteta mund të errësohet për një kohë, por nuk shuhet kurrë. Tit – LIVI
3. Në çdo çast e dimë çka dëshirojmë, por nuk e dimë se kur është çasti. H. De Balzak
4. Njeriu i shëndoshë ka me qindra dëshira, ndërsa i sëmurë vetëm një – të jetë i shëndoshë. P. popullor
5. Njeriu ka shumë dëshira, por në fund ndahet i kënaqur që nuk i janë plotësuar të gjitha. B. AUERBACH
6. Mos e lavdëro ditën pa ardhur mbrëmja. POPULLI
7. Duaji armiq të e tu, janë ata që i zbulojnë defektet e tua. B. FRANKLIN
8. Tre veta mund ta ruajnë një të fshehtë, në qoftë se dy prej tyre vdesin.
9. Kur njeriu është i ri zemra e tij jeton ardhmërinë, ndërsa kur plaket zemra e tij jeton të kaluarën. R. RAYMOND
10. Përtacia ecën aq ngadalë sa që varfëria e mbërrin shpejt. B. FRANKLIN
11. Kulmi i marrëzisë është kur babai yt të shpjegon se e ke prejardhjen nga majmuni.
12. Politikanët janë gjithandej të njëjtë. Ata premtojnë të ndërtojnë një urë edhe aty ku nuk ka lumë. N. HRUSHCOV
13. Buzëqeshja kushton shumë më pak se rryma elektrike, mirëpo jep shumë më tepër dritë se ajo. Rika ZARZI
14. Më mirë të humbasësh një minutë në jetë sesa ta humbësh jetën për një minutë. Proverb jugo-amerikan
15. Macja edhe po të bëhet princeshë si harron minjtë. L.BÖRNE
16. Edhe deti nuk e dëshiron bërllokun, prandaj e hedh në brigjet e tij. M. ARSANIS
17. Të metat e veta njeriu i ka si valixhe pas krahëve – nuk i sheh. ERAZMI nga Roterdami

## E kam dite se një ditë

Do të shkon Peterseni`  
Po nuk e kam dit`  
se do të vjen Joakim Rrykeri`  
Po tash edhe Kosova`  
e ka bo adet`  
nga dy kryeadminstator`  
me i ndrru për vjet`  
Dhe shqiptari`  
tradite qysh e ka`  
kur shkon mysafiri`  
me fol keq per ta`  
Por ma koheve te fundit`  
dicka nuk ashtë në terezit`  
me i ngu një herë lajmet`  
tash na vjen merzi`  
na u ka rrit penzioni`  
rrogat sjane kurkund`  
arsimtari i shkrete`  
duhet me ndehte pa punë`  
a shkohet kshtu përpara`  
o vllaznit e mi`  
Tuj vjedh njani tjetrin`  
e tuj bo dredhi`  
e koheve të fundit`  
janë bo shuumë kullera` nga 10 merta  
larg`  
atyre ju vjen era`  
shkojne në biblioteke`  
kiske dicka me msu`  
5 sahat 2 faqe`  
nuk munden me i kuptu`  
Se a shkohët kshtu përpara`  
këtë gjë nuk din kush me e kuptu`  
nuk e di se qysh Perendimi`  
ne BE ka me na pranu`

06-03-2007

**Ilir DESKU**





## HORIZONTALISHT

1. Kali me krahë – Hyjnor, 2. AKR – Markë e veturave – Kodra, 3. Gjendje e humbjes së kontrollit të zemrës, 4. Boksieri gjerman, Hofman – IRV – ALLBI, 5. Sofër – A – ST – Ujdhese ..... , 6. Prejardhje e një populli – Fosfor – ID, 7. Ulu (ang.) – Instituti, 8. TN – Spanja – Litër – ES, 9. OC – Itali – Tezja ose halla, 10. Emër mashkulli – Germanium – Bor, 11. ILRM – Radio Televizioni i Elbasanit, Emër mashkulli – IRIB, 12. MI – Emër femre, 12. Shtëpi e famshme e modës – A – Radius, 13. E – Azot – Sport mbi akull – Itali (shkurt), 14. FA – Bërthamë në formë të lajthisë – Ton – Pranoj, 15. I – Ai që merr mito – AB, 16. Tcreg – Ecja – E, 17. T – Qytet në Shqipëri – Lëng që përdoret për ëmbëlsira, 18. EP – Nusja e djalit – Historian Tuceri.

## VERTIKALISHT

1. Minus – Ton – Estonia – Vegël muzikore tradicionale – TE, 2. Shkenca mbi ekzistencën – A – Fosfor – P, 3. Humnera – Emër mashkulli – Hartë (ang.), 4. A – Besimi në një Zot – Radius – I çuditshëm, 5. Sulfur – Zanorja e tretë – Inis Gjoni – Lloj perimesh, 6. Grup fshatarësh që punoni falas – E – Adorim, 7. Që është i lirë dhe i pavarur për të ushtruar pushtetin më të lartë pa iu nënshtruar dikujt tjetër – TEM – Pyetje për sasinë, 8. LEV – Z – Ndërtimi (ar.), 9. QOR – Sali Ahmeti – Azot – Varg njerëzish, 10. I – Bazat e Arsimit Teknik – Vendi ku kemi lindur e jetojmë dhe vendi kanë lindur të parët tanë, 11. Pa ngrënë asgjë – Udhëtim në vendet e shenjta – Saudi Joint Relief Community, 12. Lluca – N – Njësi matëse – A – ABE, 13. Që ka të bëjë me oksidim – Arkë a dollap prej xhami në një muze – ose në një ekspozitë, ku vendosen objekte të ndryshme – ER, 14. Radio televizioni italian – Adis Abeba – Tibeti.